

"Ndryshime për qëndrueshmëri"
Projekti është i financuar
nga Bashkimi Evropian

KONEKT

Apollonia Foundation
since 2007



ANALIZË E LIGJIT PËR KONTABILITETIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Borçe Smilevski
Elena Atanasovska
m-r Nenad Torteovski

PËRMBAJTJA

4

01

Rezyme përfundimtare

6

02

Hyrje

9

03

Metodologjia

11

04

Definimi i kornizës
ligjore ekzistuese

14

05

Zbatimi i ligjit për
Kontabilitetin
e Organizatave
jofitimprurëse

19

06

Kërkesa administrative të
rregulluara me Ligjin për
kontabilitetin e organizatave
jofitimprurëse

21

07

Udhëheqja e
kontabilitetit

71 *Dokumente të kontabilitetit*

72 *Librat afaristë*

73 *Ruajtja e librave afaristë dhe dokumenteve
të kontabilitetit*

74 *Plani i kontabilitetit*

75 *Vlerësimi i pozitave të bilancit dhe njohja e
të ardhurave dhe shpenzimeve*

76 *Mjete kryesore*

77 *Amortizimi i mjeteve ekzistuese*

78 *Revalorizimi i mjeteve ekzistuese*

79 *Regjistrimi*

710 *Raporte financiare dhe dorëzimi i llogarisë
përfundimtare*

711 *Regjim më i thjeshtësuar për udhëheqjen
e kontabilitetit dhe raportimit financiar të
organizatave jofitimprurëse mikro.*

49

08

Revizioni i raporteve
financiare

51

09

Shqyrtimi i mendimit të
përfaqësuesve të organizatave
joqeveritare

64

10

Stanmdarde ndërkombëtare
të kontabilitetit (IFRS) për
organizata jofitimprurëse

67

Përfundim

70

Rekomandime

Kjo analizë është përgatitur me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit "Ndryshime për qëndrueshmëri". Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi e Qendrës për politikë tatimore dhe autorëve të përmbajtjes dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.

REZYME PËRFUNDIMTARE

Analiza e cila është prezantuar më poshtë është përgatitur në kuadër të projektit “Ndryshime për qëndrueshmëri” i financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti i paraseh më shumë aktivitete të cilat kanë për qëllim të vendosin angazhime sistematike dhe të konsoliduara për mundësimin e rrethimit të qëndrueshëm financiar të organizatave qytetare. Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse paraqet pjesë të rëndësishme të këtij rrethimi dhe që këtu edhe nevoja e ndërmarrjes së aktiviteteve për analizimin e së njëjtit. Shpresojmë se kjo analizë do të stimulojë edhe pjesëmarrës të tjerë që të involvohen dhe të cilët ndoshta do të detektojnë detaje të cilat kjo analizë nuk i ka adresur, ndërsa do të jenë në dobi të arritjes së kornizës më të mirë juridike për organizatat qytetare.

Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 24/2003, 17/2011 dhe 154/2015) i rregullon parimet e kontabilitetit dhe rregullat si edhe përmbajtjen e informacioneve financiare kryesore të cilat zbardhen nga organizatat e shoqërisë civile deri tek palët e interesuara. Ligji e rregullon kornizën juridike në bazë të së cilës OSHC i njoftojnë organet

shtetërore kompetente. Duke e pasur parasysh se ligji është në funksion për 15 vjet, imponohet nevoja për analizë nëse zgjidhjet ligjore ekzistuese janë më përkatëset sipas funksioneve dhe zhvillimit të sektorit jofitimprurës deri më sot. Gjithashtu, në periudhën e deritanishme nga zbatimi i ligjit shpesh mund të dëgjohen kritika të ndryshme para së gjithash nga vetë OSHC rreth asaj nëse ligji e plotëson funksionin e tij por disi nuk mund të materializohet në poenta konkrete të cilat janë pikat të cilat mund të adresohen për shkak të përmirësimit. Kjo analizë tentoi ta bëjë pikërisht atë, t’i detektojë mangësitë dhe të përcaktojë rekomandime për tejkalimin e tyre.

Për këtë qëllim u analizua korniza ekzistuese juridike duke e përfshirë ligjin, por edhe aktet nënligjore. Përveç kornizës ligjore, kjo analizë përfshin edhe hulumtim rreth formës së pyetësorit anketues si dhe intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues relevant në lidhje me zbatimin e ligjit.

Analiza jep shqyrtim të detajuar për dispozitat e deritanishme ligjore, por jep edhe rekomandime për rishkrimin e tyre. Kështu midis rekomandimeve më kryesore janë rekomandimet vijuese:

1

Për shembull, identifikimi i nevojës për harmonizimin e ligjit dhe rregullores në lidhje me rregullat për stornimin e transaksioneve të gabuara në evidencën e kontabilitetit.

2

Me siguri njëri prej problemeve më kryesore të detektuara ka të bëjë me planin e rregulluar të kontabilitetit i cili duhet të rishikohet më në themel dhe të përshtatet me nevojat reale të OSHC si në aspektin terminologjik ashtu edhe në aspektin esencial.

3

Gjithashtu, ligji rregullon revalorizimin e mjeteve afatgjate që nuk ka kurrfarë rëndësie nga aspekti i raporteve financiare dhe sipas kësaj rekomandohet i njëjti të pezullohet si obligim nga ligji.

4

Të rregullohet obligimi për pjesën narrative dhe vërejtjet shpjeguese si plotësim i raporteve financiare të cilat dorëzohen në Regjistrin Qëndror.

5

Të rregullohen kritere të qarta për përcaktimin e OSHC të cilat nuk do t'i nënshtrohen obligimit për dorëzimin e llogarisë vjetore.

6

Të rregullohen kriteret për përcaktimin e OSHC të mëdha dhe obligimi për revizionin e raporteve të këtyre OSHC të mëdha.

Rekomandimet nga analiza do të jenë në dispozicion në institucionin nën kompetencë të së cilit është Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, ndërsa ajo është Ministria e Financave. Që këtu, shpresojmë se të njëjtat do të merren parasysh gjatë rishikimit të ardhshëm të ligjit dhe akteve të tij nënligjore.

02

HYRJJE

Analiza u dedikohet institucioneve shtetërore për zbatimin e Ligjit si dhe vetë sektorit jofitimprurës, por edhe identifikon nevoja për ndryshimin e rregullativës dhe i shërben Rrjetit për qëndrueshmëri financiare të organizatave qytetare i formuar në kuadër të projektit “Ndryshime për qëndrueshmëri”. Përmes interpretimit të dispozitave të Ligjit si dhe analizimit të zbatimit të tij praktik, analiza identifikon jokonzistencë, aspekte relevante të cilat aspak nuk janë paraparë në Ligj si dhe dispozita të cilat e vështirësojnë evidencën e kontabilitetit dhe raportimin financiar. Në fund, analiza do të rezultojë me konklutza të cilat lidhen me interpretimin dhe zbatimin e Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, akteve nënligjore, formave raportuese si dhe rekomandimeve për ndryshime dhe plotësime të mundshme.

Gjithashtu, në analizë do të përfshihen organizata të cilat kryejnë funksione të ndryshme dhe aktivitete, me qëllim që të përcaktohet nevoja e mundshme e përshtatjes së kornizës ekzistuese të unifikuar ndaj specifikave të disa llojeve të caktuara të organizatave.

Analiza përfshin edhe vlerësimin e cilësisë dhe shkallës së zbardhjes së informacioneve financiare nga sektori jofitimprurës, kërkesat në pikëpamje të evidencës së kontabilitetit si dhe vlerësimin e zbatimit të dispozitave ligjore në praktikë.

Qëllimi ynë është identifikim i mangësive ekzistuese në interpretimin dhe zbatimin e Ligjit. Konstatimet përfundimtar kanë zgjidhje të mundshme për përmirësimin e relevancës, krahasueshmërisë dhe transparencën e informacioneve financiare.

Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar nga njëra anë e lehtëson qasjen në financim, donacione, grante nga sektori jofitimprurës. Nga ana tjetër u mundëson institucioneve kompetente kontroll më efikas dhe zbatim të dispozitave ligjore.

Dizajnimi i sistemit të raportimit financiar gjithëpërfshirës paraqet sfidë pikërisht për specifikat e sektorit jofitimprurës. Karakteristikë kryesore e punës së organizatave jofitimprurëse është realizimi i qëllimeve me interes të gjerë shoqëror. Aktivitetet e sektorit jofitimprurës i plotësojnë ose janë në lidhje me punën e bashkësisë së biznesit, institucionet publike dhe organet shtetërore. Sektori joqeveritar sipas rregullit vepron në sfera ku sistemi i vendosur shoqëror apo ekonomik paraqet gabime dhe mangësi, ndërsa i njëjti nuk ka mekanizëm të mjaftueshëm për korrigjimin e këtyre gabimeve. Por nga ana tjetër aktivitetet e organizatave janë në mënyrë dominuese pa orientim tregtar dhe kështu nuk kanë kapacitet që ta mbështesin punën e tyre me mjete personale.

Përvoja deri më tani konstaton se sektori jofitimprurës si korrektiv në funksionimin e sistemeve më të gjera të organizuara prej shtetit apo sektorit privat kryen detyra me vlerë të shtuar. Për sigurimin e një vendi në mjedis me rëndësi të madhe është kapaciteti i organizatave për të siguruar financim, me ç'rast për këto qëllime imponohen dy çështje me rëndësi kritike:

1

Transparenca në pikëpamje të qëllimeve dhe misionit, gjegjësisht cila ka qenë vlera e shtuar e projekteve të planifikuara dhe aktiviteteve të ndërmarra (Aspekt i cili nuk mund në mënyrë kuantitative të matet përmes përfitimit të realizuar për vitin) dhe

2

Transparencë e cilat lidhet me rrjedhat e parave të gatshme dhe përdorimin e resursve në realizimin e qëllimeve më të gjera dhe misionit.

Korniza ligjore, e veçanërisht Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, duhet të mundësojë në masë sa më të madhe adresimin e këtyre çështjeve, gjegjësisht format standarde të raportimit financiar dhe sistemin e kontabilitetit të vendosur mbi parimet e Ligjit, së bashku të mundësojnë informacion financiar cilësor për paraqitjen para financuesve. Nga ana tjetër është i nevojshëm plotësim i raportimit financiar me pjesën narrative pikërisht për shkak faktit që rezultatet nga puna e organizatave jofitimprurëse shpesh nuk mund të maten në mënyrë kuantitative. Korniza e vendosur në këtë mënyrë jep pasqyrë të plotë për efikasitetin në shpenzimet, gjegjësisht sa qëllime dhe vlera të shtuara janë realizuar me vëllimin e dhënë të resurseve. Konstatimet e përmbledhura për

efikasitetin e organizatës mund të zbatohen prej kontabilitetit të shpenzimeve (ku rëndësi të madhe ka përshtatshmëria e Planit të kontabilitetit) nga njëra anë dhe komenti i rezultateve dhe qëllimeve të realizuara për periudhën e përcaktuar të kontabilitetit. Raportimi financiar i strukturuar në mënyrë të tillë jep prezentim që kapaciteti i organizatës t'i maksimizojë përfitimet shoqërore, shkencore, kulturore etj. nga fondet në dispozicion përmes orientimit të dobishëm të resurseve drejt realizimit të këtyre përfitimeve. Prej raporteve financiare duhet të bëhet e qartë lidhja midis shpenzimeve dhe përfitimeve nga puna.

Përveç kësaj, organizatat jofitimprurëse zënë një pjesë të rrjedhave financiare dhe transaksioneve në sistemin financiar. Që këtu, parimet për udhëheqjen e kontabilitetit duhet të sigurojnë zbatimin efikas të kontrolleve të institucioneve kompetente dhe autoriteteve tatimore.

Qendra për politikë tatimore

Borçe Smilevski
Elena Atanasovska
m-r Nenad Torteovski

03

METODOLOGJIA



Analiza fokusohet në disa aspekte dhe sfera kryesore të hulumtimit:

- **Analizën për Ligjin për kontabilitetin e organizatave joprofitabile dhe akteve nënligjore veçanërisht planin e kontabilitetit, format e rregulluara për raportimin financiar, pozitat për raportim si dhe grupimin e evidencës së kontabilitetit sipas linjave të raportimit PADH (Përgatitja Automatike e të Dhënave).**
 - Metodën e analizimit të mendimit të fokus grupeve, gjegjësisht anketën dhe intervistën me përfaqësues të sektorit jofitimprurës, institucioneve shtetërore kompetente, me kontabilistë të autorizuar dhe revizorë të autorizuar.
 - Analizën krahasuese në lidhje me praktikën ndërkombëtare, si dhe shqyrtimin e rekomandimeve prej organizatave profesionale dhe shoqatave (ACCA, FASB, IFRS Foundation).

Në analizën e Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse identifikohen subjektet të cilat prehen në obligimin e udhëheqjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar, kërkesat administrative dhe parimet për mënyrën e udhëheqjes së kontabilitetit, rregullat e vendosura për njohjen e mjeteve, obligimet, burimet e mjeteve, të ardhurat,

shpenzimet dhe rezultatet e punës, si dhe forma për raportim financiar. Më pas analiza e ligjit i përfshiu drejtimit dhe definimin e disa termave të caktuara me rregulloret e sjella. Gjithashtu në përfshirjen e analizës u gjet interaksioni i Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse me kornizën më të gjerë juridike e cila e rregullon punën e sektorit jofitimprurës.

Më tej, kemi bërë përzgjedhjen e fokus grupeve përfaqësuesit e së cilave dhanë pikëpamjet e tyre për çështje të caktuara dhe probleme të cilat lidhen me lëndën e kësaj analize. Këtu qëllimi ishte të përfshihen të anketuarit të cilët kanë përvojë me zbatimin e Ligjit apo përvojën me kontrollin dhe rishikimin e subjekteve të cilat i nënshtrohen raportimit në pajtim me Ligjin.

U bë përzgjedhja e personave të punësuar në organizata jofitimprurëse të cilat merren me kontabilitetin dhe financat si dhe të punësuarit në kompani profesionale të cilat sigurojnë shërbime të kontabilitetit për organizata jofitimprurëse.

Gjithashtu u zbatua një pyetësor anketues përmes së cilit të anketuarit qëndrimet e tyre i shprehën si përgjigje e pyetësorit. Bëmë përzgjedhjen prej 70 organizatave të cilat veprojnë në sfera të ndryshme dhe kanë kapacitet financiar të diversifikuar. Që të sigurohet shkallë e caktuar e unifikimit dhe krahasueshmërisë së rezultateve, çdo pyetje përmban meny prej disa përgjigjeve të mundshme. Në mënyrë plotësuese për çdo pyetje është lënë hapësirë për përshkrim, komente dhe informacione plotësuese. Pyetësi i përmban 12 pyetje.

Në kuadër të studimit janë zbatuar intervistë me dy revizorë të autorizuar, një kontabilist dhe dy përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe me një përfaqësues të Ministrisë së Financave në

kompetencë të së cilës është krijimi i kornizës ligjore gjegjësisht Ligji për kontabilitetin e sektorit jofitimprurës.

Në analizë jemi përqendruar edhe tek standardet ndërkombëtare për raportimin financiar me ç'rast u identifikuan aspektet kryesore të cilat duhet të pëfshihen në ligjet kombëtare sipas komenteve të drejtuesve në IFRS Fondacionin (IFRS Foundation). Kjo organizatë është autoritet ndërkombëtar në pikëpamje të standardeve për raportim financiar pastaj rekomandimet dhe komentet e drejtuesve të saj merren me shkallë të lartë të besimit dhe relevancës.

04

DEFINIMI I KORNIZËS LIGJORE EKZISTUESE

Kërkesat minimale për udhëheqjen e kontabilitetit dhe raportimit financiar të organizatave jofitimprurëse janë rregulluar me Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 24/03, 17/11 dhe 154/15) dhe aktet nënligjore:

1

Rregulloren për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 42/03, 8/09, 12/09 dhe 175/11),

3

Rregulloren për përmbajtjen e disa llogarive të caktuara në planin e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 117/05);

2

Rregulloren për planin e kontabilitetit dhe bilancet e organizatave jofitimprurëse (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 117/05 dhe 11/06);

4

Rregulloren për të dhënat e posaçme të nevojshme për sistemin e evidencës shtetërore dhe për formën dhe përmbajtjen e formularit të evidencës shtetërore ("Gazeta zyrtare e RM-së", numër 2/08, 39/10, 13/11, 9/12 dhe 101/14).

Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse së bashku me aktet nënligjore është pjesë e kornizës juridike e cila e rregullon sektorin jofitimprurës në kuptimin më të gjerë, këtu si më të rëndësishme hyjnë:

1

Ligji për donacione dhe sponsorisime në veprimtaritë publike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 47/2006; 86/2008; 51/2011; 28/2014 dhe 153/2015).

4

Ligji për partitë politike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 76/2004; 5/2007; 8/2007; 5/2008 dhe 23/2013).

2

Ligji për shoqata dhe fondacione („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 52/2010, 135/2011 dhe 55/2016)

5

Ligji për financimin e partive politike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 76/2004; 86/2008; 161/2008; 96/2009; 148/2011; 142/2012 dhe 23/2013).

3

Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 41/1994; 7/1997 dhe 21/1998).

6

Ligji për pozitën ligjore të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 113/2007).

Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse (në tekstin e mëtejme Ligji) është sjellë në vitin 2003 me çka u vendos kornizë juridike dhe kërkesa minimale për udhëheqjen e kontabilitetit, raportimit financiar dhe administrimin e dokumentacionit nga organizatat jofitimprurëse. Në pajtim me Ligjin, janë sjellë edhe aktet nënligjore.

Më vonë, me ndryshimet e Ligjit në vitin 2011 dhe 2015 plotësohet vetëm pjesa e gjobave, dispozitave për kundërvajtje dhe pragu i pranimi të mjeteve kryesore, ndërsa definicionet esenciale dhe dispozitat të cilat e rregullojnë punën e kontabilitetit mbeten të pandryshuara deri më sot.

Korniza ligjore kryesore i definojnë llojet e subjekteve të cilat i nënshtrohen udhëheqjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në bazë të Ligjit. Më tej Ligji i rregullon dispozitat për udhëheqjen e kontabilitetit, librave afariste, dokumenteve të kontabilitetit dhe përpunimit të të dhënave, njohjes së të ardhurave dhe shpenzimeve, vlerësimin e pozitave të bilancit, revalorizimin, raportet financiare të obligueshme dhe afatet për dorëzim në institucionet kompetente.

05

ZBATIMI I LIGJIT PËR KONTABILITETIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Personat juridik me karakter jofitimprurës janë formuar për zbatimin e qëllimeve më të gjera ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, humanitare, arsimore, sportive dhe të tjera, obligohen të mbajnë kontabilitetin sipas Ligjit. Këtu hyjnë format vijuese të organizimit:

- Bashkësia ekonomike e interesit;
- Shoqatat e qytetarëve, fondacionet dhe format e tjera të bashkimit;
- Partitë politike;
- Bashkësitë fetare;
- Grupet religjioze dhe të tjera;
- Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë;
- Shoqatat për të huajt;
- Organizatat joqeveritare të huaja dhe ndërkombëtare;
- Organizatat dhe shoqatat humanitare;
- Sindikatat, dhe
- Persona të tjerë juridikë të formuar me rregulla të veçanta prej të cilave del se janë organizata jofitimprurëse

Dispozitat e Ligjit për raportim financiar, administrimin e dokumenteve dhe mënyrën e udhëheqjes së kontabilitetit, në mënyrë të unifikuar zbatohen në të gjitha subjektet pavarësisht natyrës së aktiviteteve të tyre dhe vëllimin e financimit. Gjithashtu, nuk ekziston ndarje nga aspekti i misionit dhe qëllimeve për të cilat formohen organizatat. Mund të thuhet se Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse paraqet ligj bazik në kornizën juridike e cila e rregullon sektorin jofitimprurës. Ligji e rregullon materien e cila duhet të mundësojë dokumentim, saktësi dhe cilësi të informacionit financiar. Informacioni financiar i cili merret në bazë të të hyrave të kontabilitetit më tej përdoret për qëllime të raportimit plotësues në bazë të Ligjeve të veçanta dhe kontrollit nga institucionet shtetërore dhe trupat rregullatore.

Por, Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse është pjesë e kornizës më të gjerë juridike gjegjësisht set i Ligjeve të cilat midis vete plotësohen dhe së bashku e rregullojnë punën e sektorit jofitimprurës.

Kështu ekzistojnë disa çështje të caktuara të cilat lidhen me punën e kontabilitetit, ndërsa definohen me ligje të cilat i rregullojnë disa lloje të caktuara të organizatave, gjegjësisht subjekte. Me kornizën më të gjerë ligjore janë rregulluar raporte plotësuese dhe zbardhja

e të dhënave nga disa lloje të caktuara të organizatave jofitimprurëse sipas një Ligji të veçantë. Gjithashtu, me ligj të veçantë rregullohen stimulimet tatimore për donacione dhe sponsorime në veprimtari publike, kriteret për përdorimin e të njëjtave dhe kontrolli dhe mbikëqyrja inspektuese.

Për shembull, me Ligjin për financimin e partive politike parashihet raport i veçantë financiar i partisë politike si plotësim i paketës standarde të raporteve financiare të rregulluara me Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse. Raporti i posaçëm financiar vjetor mundëson parajtje më të detajuar dhe analitike të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas llojeve, ndërsa me qëllim të mundësimit të transparencës dhe llogaridhënies më të madhe. Më tej, për partitë politike rregullohet edhe raportimi plotësues i cili përfshin specifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të llogarisë transaksionare prej fushatës zgjedhore si dhe raportimi për shpenzimet për huazimin e hapësirës reklamuese në fushatë zgjedhore

Gjithashtu, shoqatat dhe fondacionet të cilat e kanë fituar statusin e interesit publik, në pajtim me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/2010, 135/2011 dhe 55/2016) kanë obligime të veçanta për raportimin financiar. Organizata

me status me interes publik është e obliguar për punën e saj një herë në vit të dorëzojë raport afarist dhe financiar për punën e saj në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Raportimni i veçantë i Shoqatave dhe fondacioneve me interes publik përfshin një pjesë për Punën afariste në vit ku në mënyrë narrative zbardhen informacione në lidhje me veprimtarinë, veprimin e tyre, strukturën organizative, resurset njerëzore, misionin dhe aktivitetet e organizatave, buxhetin në dispozicion, transparencën dhe llogaridhënien. Pjesa e dytë ka të bëjë me punën financiare, ku ngjashëm sikurse edhe në rastin e partive politike të shoqatave dhe fondacioneve me interes publik kërkohet paraqitje e detajuar dhe analitike e shpenzimeve dhe të ardhurave sipas llojeve.

Në pjesën e kontrolleve, autorizime të veçanta i janë dhënë Drejtorisë së të Hyrave Publike (DHP) në rast të shfrytëzimit të stimulimeve tatimore prej donacionit apo sponsorimit të dhënë në pajtim me Ligjin për donacione dhe sponsorim në veprimtaritë publike (Gazeta zyrtare nr. 47/2006; 86/2008; 51/2011; 28/2014 dhe 153/2015). Këtu DHP dhe organe të tjera kompetente e kontrollojnë dhënien, pranimin dhe shfrytëzimin e donacionit dhe sponsorimit në rast të zbatimit të stimulimeve tatimore. Nëse DHP ose ndonjë organ tjetër kompetent, përcakton parregullsi dhe keqpërdorime gjatë

shfrytëzimit të donacionit dhe sponsorimit mund të ngrisë padi kundërvajtëse ose penale. Me rëndësi themelore për kontrollet tatimore është evidenca e kontabilitetit e të gjitha ngjarjeve të cilat shkaktojnë efekt financiar tek organizata jofitimprurëse, dokumentimi i transaksioneve dhe besueshmëria e sistemit informues të kontabilitetit. Të gjitha aspektet janë rregulluar me Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, i cili paraqet bazë për zbatimin e dispozitave prej Ligjeve të tjera.

Të gjitha organizatat jofitimprurëse obligohen ta udhëheqin kontabilitetin sipas sistemit të kontabilitetit të dyfishtë në mënyrë të rregulluar me ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe oligohen të përpilojnë raporte financiare kryesore, bilanc të gjendjes , bilanc të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe shënime ndaj raporteve financiare për periudhën e raportimit, gjegjësisht vitit kalendarik.

Përgjashtimi i vetëm ka të bëjë me organizatat jofitimprurëse "mikro" të cilat kanë pronë ose realizojnë të ardhura vjetore më të ulëta se EUR 2.500, këto organizata lirohen prej obligimit të udhëheqjes së kontabilitetit sipas sistemit të kontabilitetit të dyfishtë dhe për përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve financiare për vitin përkatës.

Organizatave jofitimprurëse të cilat kanë për obligim për raportim financiar plotësues në pajtim me një Ligj tjetër (Parti politike, shoqata

dhe fondacione me status me interes publik) raportojnë në mënyrë plotësuese në bazë të këtij Ligji.

Ekziston zbatim i barazuar i ligjit për organizatat jofitimprurëse vendore dhe të huaja, me ç'rast për aktivitetet të cilat zbatohen në territorin e Republikës së Maqedonisë, organizatat e huaja regjistrojnë personin juridik ose nëndegën. Në këtë pjesë Ligji për Kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse harmonizohet me Ligjin për shoqata dhe fondacione ku gjithashtu parashihen të drejta të barabarta gjatë regjistrimit në Regjistrin qendror të RM-së të një shoqate apo fondacioni të themeluar prej personave vendorë dhe të huaj, pa ekzistimin e restriksionit në pikëpamje të nacionalitetit dhe rajonit gjeografik prej të cilit vijnë.

Gjithashtu, ekziston specifikë në lidhje me bashkësinë ekonomike interesante e cila rregullohet me Ligjin për shoqatat tregtare, me ç'rast Bashkësia Ekonomike e Interesit (BEI) mund të formohet prej dy apo më shumë personave fizikë dhe juridikë me qëllim që ta lehtësojnë dhe zhvillojnë kryerjen e veprimtarive tregtare të cilat e përbëjnë lëndën e punës së tyre dhe e rrisin apo përmirësojnë rezultatit e tyre. Lëndë e punës së bashkësisë ekonomike interesante mund të jetë vetëm lidhja me veprimtaritë tregtare të cilat i kryejnë anëtarët dhe mund të jenë vetëm ndihmë e këtyre aktiviteteve. BEI për vete nuk realizon fitim,

por nëse realizohet fitimi si rezultat i punës konsiderohet si fitim i anëtareve të BEI dhe sistemohet midis tyre në pajtim me marrëveshjen për themelim apo nëse nuk ka marrëveshje ndahet në pjesë të barabarta.

Më tej, Ligji për shoqëritë tregtare parasheh dispozita për udhëheqjen e kontabilitetit, librave tregtarë dhe administrimin e dokumenteve për tregtarët në të cilat zbatohet Ligji për shoqëritë tregtare. Pas definicionit të dhënë në këtë Ligj, tregtar është çdo person i cili në mënyrë të pavarur në mënyrë të përhershme në një lloj profesioni bën veprimtari tregtare për shkak të realizimit të fitimit me prodhim, tregti dhe dhënien e shërbimeve në treg. Pasiqë BEI në mënyrë primare formohet dhe punon me karakter jofitimprurës dhe vlerësojmë se këtu do të zbatohet Ligji për udhëheqjen e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse në vend të dispozitave të cilat kanë të bëjnë me punën e kontabilitetit të shoqërive tregtare.

Me qëllim që të mos krijohet konfuzion në praktikë që rrjedh nga ndërveprimi në mes dy Ligjeve vlerësojmë se Ligji për shoqëritë tregtare duhet të plotësohet me një dispozitë që parasheh se *"Bashkësia Ekonomike e Interesit udhëheq kontabilitetin dhe libra afaristë në bazë të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse."* Edhe pse bashkësia ekonomike e interesit në mesin e grupit të gjerë të organizatave jofitimprurëse e ka komponentin

më të theksuar fitimprurës të parashikuar me Ligjin e shoqërive tregtare, para së gjithash duhet të merret parasysh qëllimi primar i themelimit dhe punës, ndërsa ai është afirmimi i veprimtarisë së anëtarëve të saj. Ky është një qëllim më i gjerë, i cili nuk përfshin një shfaqje në treg të bashkësisë ekonomike të interesit. Ndërsa në nivel sekondar, nuk përjashtohet mundësia që BEI të realizojë përfitim nga aktivitete të caktuara. Ajo që e dallon bashkësinë ekonomike të interesit nga shoqatat dhe fondacionet e tjera është mundësia e ndarjes së fitimeve të fituara me anëtarët.

Mundësia për realizimin e fitimit të caktuar ekziston edhe tek shoqatat dhe fondacionet e tjera, me ç'rast shoqatat dhe fondacionet gjithashtu nuk themelohen me qëllimin primar realizimin e fitimit por mund të kryejnë veprimtari me të cilat do të realizojnë ndonjë përfitim të caktuar, i cili duhet të dalë prej qëllimeve të punës së përcaktuara me statusin e organizatës dhe përfitimi të përdoret për realizimin e qëllimeve të përcaktuara me statutin e organizatës. Më pas fitimi i realizuar nuk mund të ndahet midis themeluesve, anëtarëve, drejtorëve, të punësuarve apo cilitdo personi tjetër të lidhur me ta.

06

KËRKESA ADMINISTRATIVE TË RREGULLUARA ME LIGJIN PËR KONTABILITETIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Funksioni administrativ në organizatat jofitimprurëse në masë të madhe varet prej natyrës së veprimtarisë si dhe prej formës së themelimit. Për dallim prej sektorit të biznesit, në sektorin jofitimprurës prioritet zakonisht është komponenti social si dhe realizimi i misionit dhe aktivitetet e planifikuara, kështu rezultatet e punës nuk mund të maten tërësisht përmes treguesve financiarë.

Financat, administrata dhe kontabiliteti shpesh konsiderohen si funksion dytësor, por organizatat jofitimprurëse gjithsesi një pjesë të resurseve të tyre i drejtojnë për zbatimin e

këtyre funksioneve. Funksioni i kontabilitetit duhet të jetë në nivel të kërkesave minimale të rregulluara me Ligjin. Organizatat mund të vendosin procedura plotësuese të kontabilitetit dhe administrative me qëllim të sigurimit të transparencës më të madhe të cilësisë së informacionit financiar. Kjo veçanërisht ka të bëjë me organizatat jofitimprurëse të cilat rregullohen me Ligje të veçanta dhe të cilat u nënshtrohen raporteve financiare plotësuese (parti politike dhe shoqata dhe fondacione me status të interesit publik). Padyshim, sistemi i kontabilitetit tek këto organizata duhet të mundësojë analitikë plotësuese për përgatitjen e raporteve financiare vjetore të rregulluara me Ligj të veçantë.

Vendimi për atë se në cilën mënyrë do të organizohet dhe udhëhiqet puna financiare duke e përfshirë administratën dhe pjesën për kontabilitet varet prej kërkesave të palëve të interesuara, donatëroëve kryesorë, menaxhmentit, vëllimit të aktiviteteve si dhe me natyrën e veprimtarisë.

Ligji vendos kornizë të unifikuar lidhur me udhëheqjen e librave afaristë, dokumentimit dhe përpunimit të të dhënave. Këtu në masë të madhe janë dhënë drejtime precize por ka edhe pjesë të cilat mundësojnë një fleksibilitet të caktuar.

07

UDHËHEQJA E KONTABILITETIT



Është zbatuar koncepti i kontabilitetit të dyfishtë, me ç'rast çdo ngjarje e kontabilitetit evidentohet në më së shumti dy llogari të Planit të kontabilitetit.

Koncepti kryesor për mbajtjen e kontabilitetit të dyfishtë zbatohet edhe në sektorin jofitimprurës që paraqet kërkesë çdo transaksion të evidentohet së paku në dy llogari të ndryshme me efekt të barabartë dhe të kundërt, gjegjësisht çdo ngjarje e kontabiliteti evidentohet në të paktën dy llogari prej Planit të kontabilitetit. Për shembull, pagesa e shpenzimeve të përgjithshme reflektohet në raportet financiare përmes zvogëlimit të faturës për para të gatshme (100)

dhe rritjes së faturës për shpenzime (401), të ardhurat prej anëtarësisë shkaktojnë rritje të faturës për para të gatshme (100) dhe rritje të njëhershme të të ardhurave sipas anëtarësisë së llogarisë (730) etj.

Më tej rregullohet kërkesat e organizatave jofitim prurëse ta udhëheqin kontabilitetin, të përpilojnë dhe dorëzojnë dëshmi të kontabilitetit në pajtim me Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe me parimet

e pranuar të kontabilitetit, praktikës dhe standardeve të kontabilitetit në qoftë se nuk janë në kundërshtim me Ligjin apo rregulla të tjera, ndërsa me qëllim të paraqitjes sa më të saktë, të vërtetë, të sigurt, gjithëpërfshirës, në kohë, të azhurnuar dhe të mëvetësishëm të pozitive të bilancit, gjendjes së mjeteve, obligimeve, burimeve të mjeteve, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe rezultateve prej punës.

Ky definicion i gjerë mundëson që në mënyrë plotësuese të mbështetemi në kornizën SNRF në qoftë se në praktikë paraqiten ngjarje të kontabilitetit të cilat në mënyrë të veçantë janë të përfshira në Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, veçanërisht të SNRF për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, derisa ndonjë trajtim i kontabilitetit i cili del nga leximi i standardeve SNRF nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe aktet e tij nënligjore.

Organizatave jofitimprurëse i udhëheqin librat afaristë në gjuhën maqedonase, me shifra arabe dhe vlera të shprehura në denarë.

Udhëheqja e kontabilitetit mund t'i besohet një organizate profesionale të autorizuar, por me këtë nuk zvogëlohet përgjegjësia tek personat përgjegjës të organizatave jofitimprurëse për kontabilitetin e përgjithshëm.

Lidhur me përpunimin e të dhënave dhe evidentimin e ngjarjeve të kontabilitetit, lihet hapësirë organizata të vendos nëse do ta përdor përlogaritës, udhëheqjen gjysmëautomatike apo në dorë të kontabilitetit. Por, pavarësisht metodës së shfrytëzuar, evidenca e kontabilitetit duhet të jetë e plotë, e kompletuar, në kohë, azhurnuar dhe sipas radhitjes kronologjike, gjegjësisht të dhënat në mënyrë të saktë ta reflektojnë raqadhitjen kohore të ngjarjeve të kontabilitetit.

Gjithashtu, një e dhënë e regjistruar në librat afaristë nuk guxon të ndryshojë dhe të plotësohet në mënyrë që më vonë do ta pamundësojë përcaktimin e përmbajtjes së regjistruar të gjendjes fillestare. Më tej Rregullorja për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse (Gazeta zyrtare nr. 42/03 dhe 08/09) rregullon kërkesa detajuese të cilat kanë të bëjnë me udhëheqjen e rregullt të librave afaristë, edhe atë:

1

Librat afaristë duhet të mundësojnë përcaktimin e saktë të ndryshimeve afariste, gjegjësisht transaksioneve, të elaboruara në ndryshime afariste individuale, në mënyrë kronologjike, në shuma bruto;

2

Nuk lihen zbrazëtira, por në mënyrë kronologjike plotësohet e gjithë hapësira për regjistrim;

3

Regjistrimi të mos fshihet e as të mos korrigohet, ndërsa nëse megjithatë bëhet korrigjim, atëherë ai duhet bërë në mënyrë që qartë të shihet teksti i gjendjes fillestare;

4

Të mos bëhen kurrfarë ndryshimesh për të cilat nuk mund të përcaktohet nëse janë kryer gjatë regjistrimit të parë apo në mënyrë plotësuese;

5

Fletët e palidhura të librit nuk guxojnë të asgjësohen e as të nxirren fletë nga libri i lidhur;

6

Të gjitha regjistrimet duhet të regjistrohen në dokumentet e kontabilitetit prej të cilave mund të përcaktohet baza e regjistrimit;

7

Stornimi i ndryshimeve afariste të regjistruara në mënyrë të gabuar të bëhet në mënyrë të obligueshme me mtodën e stornimit me të kuqe.

8

Organizatrat jofitimprurëse të cilat regjistrimin e bëjnë me përllogaritës mekanik apo elektronik pa mjet refuzimi të shumave të regjistruara, bëjnë regjistrim storno në mënyrën që e lejojnë këta përllogaritës.

Trendet për automatizimin e proceseve ndiqen edhe në sektorin jofitimprurës dhe kështu pothuajse nuk ka organizim apo kompani profesionale për shërbime të kontabilitetit të cilat në mënyrë manuale e udhëheqin kontabilitetin.

Kompjuterët përdoren shumë por edhe këtu parashtrahet pyetja për harmonizimin e sistemit informativ të kontabilitetit me kërkesat të cilat dalin prej kornizës ligjore. Padyshim se softueri i sofistikuar i kontabilitetit përmban përmbledhje programesh, procedurash, algoritmesh të cilat merren me përpunimin e të dhënave dhe janë mjaft stabile të mundësojnë evidencë të rregullt dhe të drejtë të kontabilitetit të bartësve përkatës të të dhënave. Gjithashtu, këto zgjidhje ofrojnë mundësi për kufizimin e privilegjeve të përdoruesit në pikëpamje të fshirjes dhe ndryshimit të regjistrimeve të kontabilitetit në mënyrë e cila është në kundërshtim me dispozitat e rregulluara me Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe Rregulloren.

Edhe pse Ligji jep mundësi për përpunim gjysmëautomatik të të dhënave, megjithatë edhe kjo zgjidhje duhet të sigurojë udhëheqje të rregullt dhe të azhurnuar të librave afaristë. Këtu nuk është i mjaftueshëm përdorimi i paketës Microsoft Office, por sipas Nenit 12 të Rregullores gjatë përpunimit gjysmëautomatik, librat afaristë udhëhiqen në formë të fletave

të lira apo të lidhura gjegjësisht për çdo ngjarje kontabiliteti duhet të ekzistojë evidencë në letër gjatë përpunimit gjysmëautomatik të të dhënave.

Sipas Rregullores futja e të dhënave në librat afaristë organizohet në mënyrë e cila i siguron kërkesat minimale vijuese:

- kontrollin e të dhënave të futura,
- rregullshmërinë e të dhënave të futura,
- ruajtjen e të dhënave,
- mundësinë për përdorimin e të dhënave,
- mundësinë për të pasur pasqyrë në gjendjen dhe ndryshimet në librin kryesor,
- mundësinë për të pasur pasqyrë në kronologjinë e futjes së kryer të të dhënave financiare, gjegjësisht ndryshimeve.

Për shembull, derisa Neni 5, pika 3 e Ligjit parasheh: *“Të dhënë të regjistruar në librin afarist nuk guxon të ndryshohet dhe plotësohet në mënyrë e cila më vonë do ta pamundësojë përcaktimin e përmbajtjes nga regjistrimi i gjendjes fillestare”*, megjithatë ekziston një konfuzion i caktuar kur e lexojmë paragrafin (1) të Nenit 10 nga Rregullorja e cila thotë: *“Stornimi i ndryshimeve afariste të regjistruara në mënyrë të gabuar bëhet në mënyrë të patjetërsueshme sipas metodës së stornos së kuqe”* me ç’rast ky

paragraf është në kontradiktë me paragrafin (2) të Nenit 10 nga Rregullorja e cila thotë: *“Organizatat jofitimprurëse të cilat regjistrimin e bëjnë me përlllogaritësin mekanik apo elektronik pa mjet për refuzimin e shumave të regjistruara, bëjnë regjistrim storno sipas mënyrës që e mundësojnë këta përlllogaritës”*. Që këtu në nenin e njëjtë të Rregullores kemi përcaktim eksplisit për patjetërsueshmërinë e metodës

së stornos së kuqe dhe dispozita e radhës e cila mundëson një tolerancë të caktuar varësisht karakteristikave të softuerit kompjuterik i cili përdoret, me ç’rast dy dëshmitë vetvetiu janë kontradiktore.

7.1. Dokumente të kontabilitetit

Dokumentet e kontabilitetit (profatura, fatura, vërtetimi i kontabilitetit, situata e përkohshme, kompensimi, marrëveshjet të cilat dalin prej obligimeve financiare etj) paraqesin dëshmi me shkrim se një transaksion me të vërtetë ka ndodhur dhe të njëjtat duhet të regjistrohen në momentin kur ndodh transaksioni.

Dokumenti i kontabilitetit duhet t’i përmbajë të gjitha të dhënat të cilat janë të nevojshme për futjen e evidencës kontabiliste, si për shembull vendin dhe kohën e përpilimit, përmbajtjen materiale, personin e autorizuar dhe nënshkrimin

e personit të autorizuar. Gabimet në dokument nuk guxojnë të fshihen apo të korigjohen nëse nuk shihet teksti fillestar. Korigjimet bëhen me shlyerjen me një vijë dhe futjen e ndryshimit.

Gjithashtu, rregullohet edhe kontrolli i obligueshëm i dokumenteve para futjes së evidencës së kontabilitetit.

Dokumentet e kontabilitetit duhet të përgatiten në mënyrë të qartë e cila qartë e reflekton natyrën e transaksionit.

7.2. Libra afaristë

Libra afaristë të organizatave jofitimprurëse janë: ditari, libri kryesor dhe librat ndihmës.

Libri kryesor paraqet libër për evidentimin sistematik të kontabilitetit të ndryshimeve afariste, gjegjësisht transaksioneve të cilat ndodhin tek të ardhurat dhe shpenzimet si dhe të mjeteve, obligimeve dhe burimeve të mjeteve.

Libra ndihmës të obligueshëm të rregulluara me Ligj janë:

- libri për arkën,
- libri për furnizime,
- libri për (regjistrimin) pronën kapitale - mjete të përhershme,
- libri për llogari hyrëse dhe libri për llogari dalëse.

Rregullorja jep përshkrim më të detajuar të librave afaristë, por lë hapësirë organizata të mos udhëheqë ditari të veçantë nëse në kontabilitet zbatohet përlllogaritësi elektronik apo mjetet

mekanike për futjen e të dhënave nëse me futjen e tillë të të dhënave sigurohet kontroll dhe futje kronologjike e ndryshimeve afariste. Rregullorja parasheh lirim të njëjtë prej obligimit për udhëheqjen e librave ndihmës. Gjithashtu, organizata nuk është e patjetërsueshme të udhëheq libra ndihmës nëse me ndarjen e drejtpërdrejt të zërave (paragrafëve) në librin kryesor (evidencën analitike) i siguron të dhënat e nevojshme.

Rregullorja e cila është sjellë në bazë të Ligjit kryesor shërben për sqarimin dhe precizimin e dispozitave të tij, por në asnjë rast nuk guxon të përmbajë dispozita kontradiktore me dispozitat e Ligjit themelor e as të parashohë përjashtime të caktuara dhe lirimin prej dispozitave të Ligjit kryesor, pasi që kjo qasje në mënyrë definitive krijon konfuzion në zbatim.

Përjashtimet eventuale prej kërkesave të obligueshme ligjore duhet të futen në tekstin bazë të Ligjit. Këtu do ta veçonim Librin për regjistrimin e pronës kapitale – mjetet e vazhdueshme (librin ndihmës) për të cilin konsiderojmë se duhet të mbetet obligim i patjetërsueshëm pavarësisht mënyrës së udhëheqjes së librit kryesor, para së gjithash për atë që listat e regjistrimeve vetvetiu paraqesin bazë për përcaktimin e gjendjes së mjeteve të përhershme në fund të periudhës së raportimit (vitit kalendarik).

7.3. Ruajtja e librave afaristë dhe dokumenteve të kontabilitetit

Organizatat jofitimprurëse obligohen, t'i ruajnë librat afaristë në afatet e përcaktuara dhe në çdo kohë të sigurojnë qasje dhe mundësi për prezantimin e së njëjtave.

Afatet për ruajtjen e librave afaristë dhe dokumenteve të kontabilitetit:

- Ditari dhe libri kryesor – dhjetë vjet;
- Librat ndihmës (evidencë analitike) të cilat përdoren për përpilimin e librave tregtarë – pesë vjet;
- Llogaria vjetore ruhet përgjithmonë në formën e burimit;
- Në mënyrë të përhershme ruhet përlllogaritja finale e pagave të të punësuarve si dhe listat pagesore të pagave të të punësuarve nëse përmbajnë të dhëna të rëndësishme për të punësuarit;
- Dokumentet e kontabilitetit në bazë të së cilave janë futur të dhënat në librat afaristë pesë vjet;
- Korrigjimet të cilat kanë të bëjnë me qarkullimin pagesor ruhet tre vjet;
- Bllloqet shitëse dhe kontrolluese, përlllogaritjet ndihmëse dhe korrigjimet e ngjashme ruhen tre vjet.

7.4. Plani i kontabilitetit

Organizatave jofitimprurëse librin kryesor e udhëheqin me ndryshimin e faturave të rregulluara në planin e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse përmbajtja e faturave të së cilave në mënyrë më të detajuar është përshkruar në Rregulloren për përmbajtjen e disa faturave të veçanta në planin e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse.

Gjendja dhe lëvizjet e mjeteve, burimet e mjeteve, të ardhurat dhe hyrjet e tjera, shpenzimet dhe daljet e tjera, përcaktimi dhe ndarja e rezultatit prej punës, evidentohen në llogari apo fatura sintetike (trashifrore) në Planin e kontabilitetit.

Më tej organizimi mund të zhvillojë analitikë plotësuese e cila lidhet me tri shifrat e obligueshme të para prej planit të kontabilitetit (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 117/05 dhe 11/06).

Shqyrtimi i klasave dhe nëngrupeve të Planit të kontabilitetit është dhënë më poshtë.

Klasa
0

Mjete të përhershme, mjete të tjera dhe shpenzime të pambuluara (Mjete jomateriale; Mjete materiale; Korrigjimi i vlerës së mjeteve jomateriale dhe materiale; Mjete materiale dhe jomateriale në përgatitje, Investime financiare afatgjate; Mjete të rezervave; Mjete për dedikime të tjera; Shpenzime të pambuluara – humbje)

Klasa
1

Mjete në të holla, kërkesa afatshkurtra dhe llogari aktive përlllogaritëse, (Mjete në të holla, Letra me vlerë; Blerës; Kërkesa për avance të dhëna; Depozita dhe kaucione; Kërkesa financiare afatshkurtra, kërkesa të tjera afatshkurtra, Kërkesa për më shumë tatime dhe kontribute të paguara, kufizime kohore aktive,

Klasa
2

Obligime afatshkurtra dhe fatura përllogaritëse pasive (Letra me vlerë, Furnizues, Obligime ndaj shtetit dhe institucione të tjera për tatime dhe kontribute dhe obligime të tjera, Obligime financiare afatshkurtra, Obligime të tjera afatshkurtra, Obligime afatshkurtra ndaj organizatave ndërkombëtare, Përllogaritja dhe obligime për pagat, Kufizime kohore pasive).

Klasa
3

Materiale, pjesë rezerve dhe inventar i imët (Materiale, Pjesë rezerve, Inventar i imët dhe rezerva)

Klasa
4

Shpenzime (Shpenzime materiale, shpenzime dhe amortizim; Shpenzime të tjera, Mjete për qëllime të veçanta, Mjete të transferuara, Mjete kapitale dhe të tjera, ndihma, donacione dhe shpenzime të tjera, Paga dhe kompensime të pagave, Tatime të cilat nuk varen prej rezultatit, Shpenzime jo të rregullta, Radhitja e shpenzimeve).

Klasa
5

E lirë

Klasa
6

Prodhimi, prodhimi dhe mallra

Klasa
7

Të ardhura nga shitja e produkteve të mallrave dhe shërbimeve (Të ardhura prej interesit dhe dallimeve pozitive të bursave, Të ardhura prej anëtarësisë, dhurata, donacione dhe të ardhura prej burimeve të tjera, Të ardhura prej qirave, Të ardhura personale, Të ardhura të tjera, Pjesa bartëse prej tepricës së të ardhurave prej vitit të kaluar, Të ardhura jo të rregullta, Radhitja e dallimit të të ardhurave dhe shpenzimeve)

Klasa
8

Rezultati financiar (Tepricë e realizuar e të ardhurave – fitimit para tatimit, ndarje e të ardhurave të tepërta – fitim parat tatimit, sistemimi i neto tepricës – fitimit), shpenzime të pambuluara dhe mbulimi i tyre)

Klasa
9

Burime të mjeteve (Burime të mjeteve afariste, Rezerva revalorizuese, obligime afatgjata, Burime të mjeteve të fondit rezerv, Pjesa e pasistemuar e të ardhurave të tepërta – të ardhurave, Burime të mjeteve për qëllime të tjera, Evidencë jashtë bilancit).

Më tej sintetika e cila është përpunuar në kuadër të secilit klas të mundësojë informacion financiar preciz dhe përpilim të lehtë të raporteve financiare.

Veçanërisht nëse e shohim Klasën 4 – mund të vërejmë se ekziston ndarje e llogarive sintetike në lidhje me shpenzimet për administrimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e të mirave dhe shërbimeve.

Shpenzimet për ndihmë, tatimet dhe shpenzimet e tjera të subjekteve të cilat grupohen në llogarinë 450, ndërsa duke e pasur parasysh atë se bëhet fjalë për shpenzime tipike për sektorin jofitimprurës, këtu duhet të ketë ndarje më të detajuar dhe ndarje sipas llojeve të ndihmës gjegjësisht llojeve të donacionit, sipas karakteristikave, qëllimit dhe dedikimit të donacioneve gjegjësisht dhënies së ndihmës, siç është dhënë në shembullin më poshtë:

- Ndihmë gjatë fatkeqësive elementare
- Ndihmë për mjekim
- Ndihmë për kategoritë e rrezikuara sociale
- Ndihmë tjetër
- Donacione për mbështetjen e sportit
- Donacione për ngjarje të cilat lidhen me kulturën dhe artin
- Donacione për mbajtjen e ngjarjeve humanitare
- Donacione për mbrojtjen e grupeve të marginalizuara
- Donacione për mbrojtjen e kafshëve
- Donacione për mbrojtjen e mjedisit jetësor
- Donacione të tjera

Gjithashtu, në kuadër të klasës 4 vërehet përdorimi i termit “Mjete” i cili nuk është përkatës me klasën, kështu i njëjti duhet të zëvendësohet me “Shpenzime”, Siç është paraqitur në krahasimin më poshtë:

42	Mjete për qëllime të veçanta	→	42	Shpenzime për qëllime të veçanta
43	Mjete të transferuara	→	43	Shpenzime për subjekte të tjera
	430 Mjete të transferuara subjekteve të tjera	→	430	Shpenzime për/në emër të subjekteve të tjera
44	Mjete kapitale dhe mjete të tjera	→	44	Shpenzime kapitale dhe të tjera
	440 Mjete për objekte ndërtimore	→	440	Shpenzime për objekte ndërtimore
	441 Mjete për pajisje	→	441	Shpenzime për pajisje
	442 Mjete të tjera kapitale	→	442	Shpenzime të tjera kapitale

Më tej në klasën 7 – Të ardhura gjithashtu ekziston grupim i të ardhurave më të rëndësishme në një konto sintetike. Vlerësojmë se kontoja 730 Të ardhura prej anëtarësisë (kontribute), dhurata dhe donacione duhet të ndahet, të paktën në konto sintetike të veçanta prej të cilave më tej mund të bëhet klasifikim plotësues. Është veçanërisht e rëndësishme të bëhet përkufizim i të ardhurave prej donacioneve (transferove të njëanshme), të ardhurave prej shitjes së produkteve dhe shërbimeve, të ardhura prej anëtarësisë siç është theksuar më poshtë:

■ TË ARDHURA PREJ KRYERJES SË VEPRIMTARIVE

- Të ardhura prej shërbimeve konsulente
- Të ardhura prej organizimit të trajnimeve dhe seminareve
- Të ardhura prej shërbimeve të tjera
- Të ardhura prej shitjes së biletave për ngjarje, koncerte, ekspozita etj.
- Të ardhura prej shitjes së punimeve të dorës
- Të ardhura prej shitjes së ushqimit dhe pijeve
- Të ardhura prej shitjes së revistave, publikimeve dhe broshurave
- Të ardhura prej qirave
- Të ardhura prej shitjes së mallrave tregtare
- Të ardhura të tjera nga kryerja e veprimtarive

■ TË ARDHURA NGA ANËTARËSIA

- Anëtarësi prej personave fizikë
- Anëtarësi prej personave juridikë

■ TË ARDHURA PREJ DONACIONEVE

- Të ardhura prej donacioneve prej Buxhetit shtetëror të R. së Maqedonisë;

■ Të ardhura prej donacioneve prej buxheteve të njësiteve të vetëqeverisjes lokale dhe buxhetit të Qytetit të Shkupit. ### Të ardhura prej donacioneve prej qeverive të huaja dhe organizatave ndërkombëtare (Në këtë llogari do të evidentoheshin të ardhurat prej donacioneve dhe granteve prej organizatave të huaja për ndihmë ndërkombëtare dhe zhvillim (USAID, SDC etj.), Bashkimi Evropian, donatorët bilateral (ambasadat e huaja) dhe fondacione të tjera selia e së cilave është jashtë R. së Maqedonisë.

■ Të ardhura prej donacioneve prej fondacioneve dhe organizatave vendore (Në këtë llogari do të evidentoheshin të ardhurat prej donacioneve dhe granteve prej subjekte fondacioneve jofitimprurëse vendore, shoqatat dhe lidhjet e tjera etj.).

■ Të ardhura prej donacioneve prej biznes sektorit (Këtu hyjnë të ardhurat prej donacioneve prej shoqërive tregtare, institucionet financiare private dhe subjekte të tjera afariste.

■ Të ardhura prej donacioneve prej personave fizik

■ TË ARDHURA PREJ SPONSORIMEVE

■ Të ardhura prej sponsorimeve

■ TË ARDHURA TË TJERA

- Të ardhura prej dhuratave
- Të ardhura prej ngjarjeve humanitare për grumbullimin e mjeteve (Në këtë llogari do të evidentoheshin të ardhurat prej arkave të vogla për donacion, ankandeve të bamirësisë etj.
- Të ardhura prej të dhënave prej televizioneve

Gjithashtu, sintetika e rregulluar me Planin e kontabilitetit nuk është në masë të mjaftueshme e detajuar për qëllimet e raportimit financiar vjetor i rregulluar me ligj të veçantë (Partitë politike dhe Shoqatat dhe fondacionet me status të interesit publik). Që t'u përgjigjen në mënyrë përkatëse kërkesave për raportimin plotësues vjetor deri tek institucionet kompetente këto subjekte duhet të kenë të përpunuar analitikë personale në bazë të llogarive sintetike të vendosura gjegjësisht në bazë të llogarive sintetike me përshkrim i cili është më i afërt me natyrën e ngjarjeve konkrete të kontabilitetit.

Më tej prej intervistave të zbatuara me fokus grupet, prej një përfaqësuesi të Lidhjes së pensionistëve u theksua se pjesa më e madhe e shpenzimeve të organizatës kanë të bëjnë

me ekskursione, vizita në ngjarje të ndryshme kulturoro-artistike dhe aktivitete të ngjashme, por për evidentimin e këtyre shpenzimeve nuk gjejnë llogari sintetike përkatëse në klasën 4 prej Planit të kontabilitetit dhe organizata e njëjtë duhet t'i evidentojë shpenzimet për këto ngjarje në faturën analitike nën sistetikën për shpenzime të tjera. Me qëllim që të bëhet harmonizimi me Ligjin për të ardhura personale të shpenzimeve, u potencua nevoja e hapjes së llogarisë e cila ka të bëjë me shpenzime të cilat janë në funksion të veprimtarisë, pasi që këto shpenzime të cilat nuk janë në funksion të veprimtarisë nuk pranohen për qëllime tatimore.

Padyshim se llogaritë sintetike të Planit të Kontabilitetit nuk mundën tërësisht të përkojnë me të gjitha aktivitetet e organizatës, por është e nevojshme të ekzistojnë llogari sintetike të cilat në masë të madhe do të përkojnë me një grup të caktuar të transaksioneve të ngjashme. Këtu do të ishte e papranueshme nëse paraqitet situatë ku disa organizata të caktuara e evidentojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të veta në llogari analitike e cila do të lidhet me sintetikën për të ardhura të tjera ose shpenzime të tjera, për shkak të mosekzistimit të një Plani detajues të kontabilitetit.

7.5. Vlerësimi i pozitive të bilancit dhe njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve



Zbatohet parimi i dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste, me ç'rast

- mjetet afatgjata evidentohen sipas vlerës së tyre të furnizimit, mjetet në të holla sipas vlerës së tyre nominale, ndërsa kërkesat dhe detyrimet sipas vlerës së dakorduar;
- të ardhurat njihen në periudhën përlllogaritëse në të cilën kanë dhodhur sipas kriterit të matshmërisë dhe disponueshmërisë;
- shpenzimet njihen në periudhën përlllogaritëse në të cilën janë krijuar

Pozitat e bilancit në bilancin e gjendjes vlerësohen sipas parimit të kontabilitetit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste, me ç'rast mjetet afatgjata evidentohen sipas vlerës së tyre shtesë, mjetet financiare sipas vlerës së tyre nominale, ndërsa kërkesat dhe obligimet sipas vlerës së dakorduar.

Të ardhurat dhe shpenzimet e organizatave jofitimprurëse njihen sipas parimit të kontabilitetit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste. Parimi i kontabilitetit i dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste gjegjësisht transaksioneve do të thotë të ardhurat njihen në periudhën përlllogaritëse në të cilën janë krijuar sipas kriterit të matjes dhe disponueshmërisë.

Matja do të thotë se të ardhurat mund të shprehen sipas vlerës në evidencën e kontabilitetit. Të ardhurat janë të disponueshme kur të njëjtat janë realizuar (paguar) në periudhën përlllogaritëse ose në periudhë prej 30 ditësh

pas skadimit të periudhës përlllogaritëse vetëm nëse të njëjtat kanë të bëjnë në periudhën përlllogaritëse dhe shërbejnë për mbulimin e obligimeve të kësaj periudhe përlllogaritëse.

Zbatimi i parimit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste u diskutua në kuadër të një grupi të fokusit të përbërë nga përfaqësues nga sektori jofitimprurës dhe kontabilistë të organizatave jofitimprurëse. Midis tjerash, pjesëmarrësit theksuan se Ligji nuk jep një përkufizim të qartë të kriterëve të matshmërisë dhe disponueshmërisë që zbatohen në njohjen e të ardhurave nga periudha aktuale. Për më tepër, Rregullorja nuk përmban saktësi të mjaftueshme, kështu që këto kriterë janë identifikuar si sferakryesore të pasigurisë në zbatimin e Ligjit.

Sidomos për shkak se kriteri i disponueshmërisë nënkupton përmbushjen e njëkohshme të dy kushteve dhe ajo është të ardhurat të jenë realizuar (paguar) në periudhën aktuale dhe i referohen mbulimit të obligimeve të së njëjtës periudhë për pjesën e të ardhurave të cilat janë realizuar 30 ditë pas skadimit të periudhës përlllogaritëse. Kështu, në praktikë, mund të lindë një situatë kur të ardhurat e realizuara gjatë këtyre 30 ditëve pas skadimit të periudhës për përlllogaritje të jenë në shumë më të madhe sesa pjesa që lidhet me mbulimin e obligimeve të kësaj periudhe përlllogaritëse me ç'rast do të duhej, si të ardhura në periudhën aktuale të evidentohet vetëm pjesa që lidhet me mbulimin e detyrimeve.

Kriteri i disponueshmërisë së të ardhurave është në funksion të detyrave themelore të raportimit financiar, që është të tregojë nëse organizata ka aftësinë për të mbuluar detyrimet e realizuara nga të hyrat e realizuara për vitin dhe nëse fondet janë përdorur sipas qëllimeve dhe misionit të përcaktuar.

Dhe kështu, nëse organizata ka hyrje në periudhën aktuale që i referohet periudhave të shumëfishta përlllogaritëse në përputhje me parimin e matshmërisë dhe disponueshmërisë, të ardhurat e përgjithshme do të njihen në periudhën aktuale dhe viti financiar do të përfundojë me një tepricë fondesh që do të përdoren në periudhat e ardhshme të përlllogaritjes.

Shpenzimet njihen në periudhën e përlllogaritjes në të cilën ndodhën ose në periudhën deri në 30 ditë pas skadimit të periudhës përlllogaritëse, vetëm nëse detyrimi i pagesës ka ndodhur në atë periudhë përlllogaritëse. Në pjesën e shpenzimeve ne nuk kemi një modifikim në kriterin e krijimit (accrual basis).

7.6. Mjete themelore

Mjetet afatgjata vlera e mëvetësishme e së cilave në momentin e furnizimit është më e lartë se 300 euro në kundërvlerë denari klasifikohen si mjete kryesore.

Në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit një mjet duhet të shfaqet si mjet afatgjatë vetëm nëse është sigurt se dobitë e ardhshme ekonomike do të paraqesin të ardhura për entitetin dhe nëse vlera furnizuese e mjetit

mund të matet në mënyrë të besueshme, pavarësisht shumës e cila është paguar për këtë mjet. Për këtë duhet të analizohet nëse është e nevojshme të vihet pragu i vlerës prej 300 euro në kundërvlerë denari i cili është marrë si kriter i vetëm. Mendimi ynë është se vlerësimi i menaxhmentit për përdorimin e ardhshëm të një mjeti të caktuar dhe dobitë e pritshme prej tij është kriter më valid se vlera e mjetit për shumë absolute.

7.7. Amortizimi i mjeteve të vazhdueshme



Mjetet afatgjata amortizohen në një linjë me zbatimin e shkallëve vjetore, të rregulluara me Rregulloren për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse.

Në evidencën e kontabilitetit për shumën e amortizimit përlogaritës zvogëlohen edhe mjetet edhe burimet e financimit (fondit afarist).

Mjetet afatgjata amortizohen në një linjë me zbatimin e shkallëve vjetore, të rregulluara me Rregulloren për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse.

Kryegjësja e rregulluar për shlyerjen e vlerës së furnizuar apo revalorizuese të mjetit. Kjo dispozitë nuk jep udhëzime të qarta në cilin rast merret vlera e blerjes dhe në cilin rast vlera

e rivalorizimit si bazë amortizimi, duke e pasur parasysh atë që organizatat jofitimprurëse gjithashtu kanë një detyrim për rivalorizimin e detyrueshëm vjetor duke zbatuar rritjen e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale . Gjegjesisht me fundin e vitit një mjet e ka vlerën e saj furnizuese por edhe revalorizuese.

Një përkufizim i tillë lë hapësirë për interpretim dhe zbatim të pabarabartë të dispozitave të ligjit në praktikë. Kështu vlerësojmë se si bazë e amortizimit duhet të merret vetëm vlera e furnizuar e mjetit.

Më tej, baza për amortizimin e mjeteve afatgjata (mjetet materiale dhe jomateriale) korrigohet për shpenzimet kapitale pasuese me të cilat përmirësohet gjendja e mjetit mbi jetëgjatësinë e tij të përdorimit, gjegjesisht për investimet për investimet për shkak të rikonstruimit, adaptimit apo investime të tjera me të cilat rritet jetëgjatësia e përdorimit, kapacitetit, lidhshmërisë funksionale etj.

Llogaritja e amortizimit të mjeteve jomateriale fillon të bëhet prej ditës së parë të muajit të

ardhshëm, që kur këto mjete janë të gatshme për përdorim, gjegjësisht të mjeteve materialeve nga dita e parë e muajit të ardhshëm, që kur këto mjete janë vënë në përdorim në funksion të aktivitetit. Përlllogaritja e amortizimit nuk ndalet deri në përdorimin e plotë të veprimtarisë. Me përjashtim përlllogaritja e amortizimit mund të ndalojë në një kohë të caktuar nëse mjete është dëmtuar për shkak të një force të mbinatyrshe (tërmet, përmytje, zjarr, etj). dhe në qoftë se mjete nuk është në funksion për shkak të masës së institucionit shtetëror kompetent në të cilin nuk mund të ndikohet.

Përlllogaritja e amortizimit nuk ka të bëjë me:

1

toka dhe pyjet si pasuri natyrore të cilat nuk shpenzohen;

2

objektet ndërtimore dhe lëndët të cilat në pajtim me ligjin janë shpallur si rëndësi kulturore, historike dhe artistike dhe librat në biblioteka;

3

mjetet afatgjate deri në lënien e tyre në përdorim;

4

mjetet afatgjate të cilat në mënyrë të përhershme janë jashtë përdorimit (mjetet të cilat janë vendim apo me një akt tjetër janë vënë jashtë përdorimit për shkak të vjetritimit fizik dhe teknik; mjetet që mbi një vjet nuk përdoren në mënyrë të pandalshme, ndërsa lënia e tyre jashtë përdorimit nuk është për shkak të riparimit apo sendërtimit; mjetet të cilat janë në fazë të furnizimit, ndërsa furnizimi i së cilave, me vendim apo me ndonjë akt tjetër anulohet apo tre vjet një pas një nuk investohen mjete për përfundimin e këtij furnizimi dhe mjetet që në pesë vitet e fundit në mënyrë të pandërprerë përdoren më pak se 30% të kapacitetit të tyre të programuar);

5

mjetet e tjera afatgjate, përdorimi i së cilave nuk kufizohet me kohë.

Mjete të cilat janë tërësisht të amortizuara mbeten në libra deri në tjetërsimin, dhurimin, shitjen apo asgjësimin e tyre.

Në këtë kategori ekziston një karakteristikë në lidhje me prezantimin e raporteve financiare. Me qëllim që të ruhet parimi i dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste gjatë vlerësimit të pozitive të bilancit të organizatave jofitimprurëse, mjete kryesore njihen si shpenzim i klasës 4 menjëherë në momentin e furnizimit të tyre dhe pagesës. Më tej me evidencën e kontabilitetit për shumën e amortizimit të përlogaritur zvogëlohen edhe mjetet dhe burimet e financimit, gjegjësisht klasa 0 dhe klasa 9.

7.8. Revalorizimi i mjeteve ekzistuese



Obligimi i vendosur për revalorizimin e mjeteve të përhershme në rastet vijuese:

- Gjatë tërheqjes së përdorimit dhe tjetërsimit të mjeteve afatgjata
- Vlerësimit të sërishëm me rritjen e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale në bazës të vazhdueshme.

Organizatat jofitimprurëse bëjnë revalorizimin e mjeteve afatgjata (materiale dhe jomateriale) në dy raste:

1

Gjatë tërheqjes së përdorimit dhe tjetërsimit të mjeteve afatgjata. Vlera revalorizuese në këtë rast përcaktohet me komision për vlerësim.

2

Për shkak të vlerësimit të sërishëm me rritjen e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale. Vlerësimi i sërishëm bëhet në bazë të rregullt, gjegjësisht duhet të reflektohet në librat për vitin kalendarik përkatës me shfrytëzimin e shkallës së rritjes së çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale, të publikuar prej Entit Shtetëror për Statistikë.

azë të revalorizimit të mjeteve afatgjata paraqet vlera e furnizuar e mjeteve e korigjuar për amortizimin e akumuluar (totali i regjistrimit të korigjuar të vlerës për mjetin kryesor nga fillimi i përdorimit).

Vlerësimi i sërishëm i mjeteve para mbylljes së librave – revalorizimi vjetor nuk përlogaritet nëse rritja e çmimeve të prodhuesve të produkteve industriale është madhësia negative dhe në kushte kur lëvizjet inflatore në ekonomi janë shumë të ulëta dhe stabile. Në rrethana të tilla revalorizimi vjetor paraqet vetëm barë administrative pa kurrfarë efekti të rëndësishëm të bilancit të gjendjes.

Zbatimi i indikatorit për rritjen e çmimeve si korigjues i mjeteve afatgjata ka rëndësi materiale vetëm në kushte të lëvizjeve të shprehura inflatore, të cilat nuk kanë ndodhur në Maqedoninë bashkëkohore e as nuk ka pritje të tilla. Përkundrazi, imperativ i institucioneve të cilat e udhëheqin dhe zbatojnë politikën monetare dhe fiskale është ruajtja e shkallëve të ulëta të inflacionit. Duke e pasur parasysh stabilitetin e ekonomisë dhe shkallët tradicionalisht të ulëta të inflacionit, vlerësojmë se dispozitat për revalorizimin vjetor të mjeteve të përhershme mund të fshihen prej Ligjit.

7.9. Regjistrimi



Së paku një herë në vit gjegjësisht me fundin e vitit financiar organizata duhet të zbatojë regjistrimin e mjeteve financiare, letrave me vlerë, mjeteve materiale dhe jomateriale të cilat janë në përdorim, jashtë përdorimit dhe në përgatitje, materialeve, pjesëve rezerve, inventarit të imët, kërkesave, detyrimeve, mjeteve prej një subjekti tjetër të cilat ndodhen tek organizata jofitimprurëse dhe mjetet personale të organizatës jofitimprurëse të cilat ndodhen te një subjekt tjetër në ditën e regjistrimit.

Organizatat jofitimprurëse janë të detyruara, të paktën një herë në vit, të harmonizojnë gjendjen e mjeteve dhe burimeve të tyre të paraqitura në kontabilitet me gjendjen faktike e cila përcaktohet me regjistrimin më 31 dhjetor, sipas mënyrës së rregulluar nga ministri i Financave.

Me regjistrimin përfshihen mjetet financiare, letrat me vlerë, mjetet materiale dhe jomateriale të cilat janë në përdorim, jashtë përdorimit dhe në përgatitje, materialet, pjesët rezerve, inventari i imët, kërkesat, detyrimet, mjetet prej një subjekti tjetër të cilat ndodhen tek organizata jofitimprurëse dhe mjetet personale të organizatës jofitimprurëse të cilat ndodhen te një subjekt tjetër më datë 31 dhjetor.

Rregullorja parashikon një përgjashtim për organizatat që merren me librari apo aktivitetin e bibliotekave dhe në drejtim të mjeteve specifike (libra, dokumente, filma, fotografi, materiale arkivore, etj), për të cilat mund të organizohet inventar në periudhë më të gjatë, por jo për kohë më të gjatë se pesë vjet. Ky përgjashtim është i kuptueshëm për shkak se në organizata

që merren me librari dhe punën e bibliotekës mund të gjenden një numër i madh i publikimeve regjistrimi i të cilave kërkon angazhimin e burimeve dhe kohës së konsiderueshme për zbatimin e regjistrimit, kështu që periudha prej një viti është e shkurtër për këtë angazhim dhe në mënyrë të tepruar do t'i ngarkonte këto organizata me punë administrative. Por edhe këtu vlerësojmë se përjashtimet nga dispozitat themelore të Ligjit gjithashtu duhet të përcaktohen në vetë Ligjin dhe jo në aktet nënligjore.

Më tej, menaxhmenti i organizatave sjell vendim për formomin e komisionit për regjistrim dhe përcaktimin e detyrave, personave të cilët në mënyrë materiale obligohen për mjetet të cilat regjistrohen dhe drejtuesit e tyre të drejtpërdrejt, data e fillimit, koha për zbatimin e regjistrimit dhe afati për dorëzimin e raportit për regjistrimin e bërë me listat e shfaqura të regjistrimit, me atë që të gjitha punët lidhur me regjistrimin, duke e përfshirë edhe raportin dhe listat e regjistrimit të cilat dorëzohen në shërbimin e kontabilitetit, duhet të përfundojnë dhe të dorëzojnë më së voni njëzetë ditë para afatit të përcaktuar për dorëzimin e llogarisë vjetore. Listat e regjistrimit e kanë trajtimin e dokumentit të kontabilitetit vlerën e së cilit me regjistrimin e përcaktojnë anëtarët e komisionit për regjistrim.

Sipas Nenit 32 të Rregullores, komisioni për regjistrim i bën detyrat vijuese:

1

përcaktimin, matjen, numërimin dhe përshkrimin më të afërt të mjeteve dhe futjen e këtyre të dhënave në listat e regjistrimit;

2

regjistrimi i ndryshimeve materiale të krijuara midis ditës së regjistrimit dhe ditës së përcaktuar në të cilën bëhet regjistrimi (neni 32 paragrafi(2));

3

futjen e gjendjes materiale të kontabilitetit në listat e regjistrimit;

4

përcaktimin e dallimeve materiale midis gjendjes së regjistrimit të përcaktuar dhe gjendjes së kontabilitetit;

5

përlogaritjen e vlerave të dallimeve të përcaktuara materiale;

6

përcaktimin e shkaqeve të mospërputhjes midis gjendjes dhe regjistrimit dhe gjendjes së kontabilitetit dhe

7

nënshkrimin e listave të regjistrimit.

Me raportet për regjistrimin, komisioni i regjistrimit duhet t'i identifikojnë dallimet në mes të regjistrave të kontabilitetit dhe gjendjes faktike të përcaktuara me numërimin fizik dhe shqyrtimin në dokumentacionin valid në varësi të llojit të mjeteve gjegjësisht obligimeve të cilat regjistrohen. Më tej, me raportin për regjistrim theksohen sqarime për dallimet e paraqitura dhe vërejtjet prej personave të cilët janë të obliguar të punojnë me vlerat materiale dhe me të hollat, propozime për regjistrimin e mungesës gjegjësisht tepricës (dallimit), propozime për hedhjen apo shlyerjen e mjeteve të pajisjes dhe inventarit të imët, masa kundër personave përgjegjës për mungesat e krijuara, dëmtimet e mjeteve dhe për kërkesat e papaguara. Në këtë pjesë, Rregullorja jep drejtime precize për procedurën dhe mënyrën e regjistrimit të çdo mjeti/obligimi që është lëndë e regjistrimit vjetor.

7.10. Raportet financiare dhe dorëzimi i llogarisë vjetore



Raporte financiare të patjetërsueshme:

- Bilanci i gjendjes,
- Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe
- Shënimet ndaj raporteve financiare.

Organizatave jofitimprurëse obligohen në fund të vitit kalendarik, të përgatisin dhe të dorëzojnë në Drejtorinë për të Hyra Publike dhe regjistrin e llogarive vjetore i cili udhëhiqet në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë një set raportesh financiare të cilat i përbëjnë :

- Bilanci i gjendjes,
- Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe
- Shënimet ndaj raporteve financiare.

Bilanci i gjendjes e tregon gjendjen e mjeteve, obligimeve dhe burimeve të mjeteve në një datë të caktuar.

Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve i shfaq të ardhurat dhe shpenzimet, gjegjësisht tepricën apo mungesën e realizuar në vitin afarist në një periudhë tjetër gjatë vitit afarist.

Shënimet ndaj raporteve financiare paraqesin përpunim të detajuar dhe plotësim të të dhënave prej bilancit të gjendjes dhe bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto raporte financiare duhet të japin shqyrtim të saktë, të vërtetë dhe të plotë të mjeteve, obligimeve, burimeve të mjeteve dhe të ardhurave dhe shpenzimeve. Raportet financiare regjistrohen nga nënshkruesi i autorizuar i organizatës jofitimprurëse ose nga personi që do ta autorizojë ai.

Lidhur me regjistrimin e llogarisë përfundimtare, duhet të merren parasysh dispozitat e Ligjit për zbatimin e punëve të kontabilitetit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 95/2012, 188/2013, 27/2014, 154/2015, 192/2015, 23/2016, 190/2016 dhe 193/2017) ku rregullohen kushtet për kryerjen e kontabilitetit nga kompanitë profesionale të cilat sigurojnë shërbime të kontabilitetit dhe kriteret për marrjen e licencës për kontabilist dhe kontabilist të autorizuar. Sipas Nenit 20, paragrafi 2 prej Ligjit për zbatimin e punëve të kontabilitetit, Kontabilisti udhëheq libra tregtarë/afaristë për të gjithë të obliguarit për udhëheqjen e kontabilitetit dhe përpilon dhe e nënshkruan llogarinë vjetore për tregtarë individë dhe shoqata dhe fondacione. Sipas kësaj del se përveç nënshkruesit të autorizuar të organizatës jofitimprurëse llogaria përfundimtare duhet të nënshkruhet edhe prej kontabilistit të autorizuar.

7.11. Regjim më i thjeshtuar për udhëheqjen e kontabilitetit dhe raportimit financiar të mikro organizatave jofitimprurëse

Organizatave jofitimprurëse vlera e përgjithshme e pronës apo të ardhurave vjetore të së cilave është më e vogël se 2.500 euro në kundërvlerë denari nuk obligohen ta udhëheqin kontabilitetin sipas sistemit të kontabilitetit të dyfishtë dhe të përpilojnë raporte financiare. Këto organizata obligohen të udhëheqin të paktën libër për kontabilitetin dhe libër të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në afatin për dorëzimin e llogarisë përfundimtare drejtuesi i organizatës dorëzon deklaratë tek institucionet kompetente se organizata për vitin përkatës kalendarik nuk ka pronë të përgjithshëm apo të ardhura më të mëdha se 2.500 euro.

Pa dyshim, kjo dispozitë ka për qëllim t'i përjashtojë "mikro" organizatat prej barës administrative të raportimit financiar duke e pasur parasysh se pjesëmarrja e tyre në lëvizjet financiare në nivel të sektorit



Mikro organizatat me vlerë të përgjithshme të pronës apo të ardhurave vjetore më të vogla se 2.500 euro në kundërvlerë denari nuk obligohen të bëjnë raporte financiare.

është margjinale dhe resurset me të cilat disponojnë janë të kufizuara, prandaj për këto organizata konsiderohet se nuk është e domosdoshme kërkesa për funksion kontabiliteti gjithëpërfshirës.

Ky qëndrim është i pranueshëm por nën kriterin e qartë për përcaktimin e "mikro" organizatave jofitimprurëse, të cilat hyjnë në këtë regjim të thjeshtuar.

Kjo veçanërisht vjen në shprehje tek organizatat ku nuk është i nevojshëm posedimi i ndonjë prone të konsiderueshme (mjete të përhershme) për zbatimin e qëllimeve dhe misionit. Shumica e organizatave nuk kanë procese prodhuese e as

produksion të të mirave materiale. Përkundrazi, aktivitetet më shumë mbështeten tek kapitale, shërbimet, hulumtimet, mbështetjen financiare prej donacioneve dhe sponsorisimeve etj. Gjegjësisht, për nga natyra e tyre organizata jofitimprurëse kryesisht shfrytëzojnë resurse dhe prodhojnë rezultate të cilat nuk kanë karakteristika të të mirave materiale gjegjësisht pronës fizike.

Sipas kësaj, vlera e pronës gjatë përcaktimit të madhësisë së organizatës nuk është kriteri më përkatës, veçanërisht nëse e vëzhgojmë në mënyrë të veçantë, duke mos i marrë parasysh mjetet vijuese.



Ligji i rregullon pronën e përgjithshme apo të ardhurat e përgjithshme si kriter sipas së cilit përjashtohen mikro organizatat nga obligimi për dorëzimin e llogarisë përfundimtare. Në një përkufizim të tillë lidhëza "apo" lë hapësirë për përzgjedhjen vullnetare të kriterit i cili do të zbatohet në situatat vijuese:

- Organizata disponon me pronë me vëllim të konsiderueshëm por për vitin përkatës kalendarik shënon të ardhura të pakonsiderueshme të cilat nuk i tejkalojnë 2.500 euro, apo
- Organizata disponon me pronë minimale e cila nuk i tejkalon 2.500 euro por realizon vëllim të konsiderueshëm të të ardhurave.

Në të dyja rastet organizata mund t'i referohet atij kriteri që e plotëson, ndërsa tërësisht ta anashkalojë kriterin e dytë, për të cilin mund të ndodh edhe tejkalimi i shumëfishtë i pragut të vendosur.

Të ardhurat e përgjithshme nga ana tjetër janë tregues i drejtpërdrejt i vëllimit të aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në lëvizjet financiare të sektorit jofitimprurës. Zbatimi i këtij kriteri mundëson klasifikim më real dhe më konsekuent si dhe tejkalimin e dallimeve në interpretimin dhe zbatimin e Ligjit.

Çështja e radhës është matja e lartësisë së pragut të vlerave, i cili është përcaktuar në nivel fiks prej 2.500 euro në bazë vjetore. Pragu i vlerave është i pandryshuar nga sjellja e Ligjit prej vitit 2003 e këtej. Vlerësojmë se, pragu për përcaktimin e subjektit të vogël (lartësia e të ardhurave nën 2.500 euro) ndryshon së bashku me zhvillimin e ekonomisë dhe lëvizjet financiare në vetë sektorin dhe nuk paraqet kategori universale gjegjësisht të pandryshueshme. Kështu nëse bëhet analizë statistikore për lëvizjen e të ardhurave të përgjithshme në nivel sektorial prej vitit 2003 e këtej u përcaktua se sektori është zhvilluar dhe të ardhurat janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, do të thotë se vlera e përcaktuar prej 2.500 euro mund të zhvendoset më lartë. Gjegjësisht, nëse analiza statistikore tregon se nuk ka zhvendosje të konsiderueshme në nivel sektorial, vlera prej 2500 euro do të konsiderohej si e fiksuar e arsyeshme. Regjistri qendror i RM-së në kompetencë të së cilit është pranimi dhe përpunimi i raporteve financiare mund të përgatisë të dhëna për të ardhurat mesatare në nivel sektorial.

Ligji gjithashtu mund të plotësohet me dispozitë për revizionin e vazhdueshëm të shumës së vendosur të të ardhurave të përgjithshme mbi të cilat organizata obligohet të dorëzojë llogari përfundimtare në pajtim me gjendjet e vlerësuarra dhe kapacitetin financiar në sektorin jofitimprurës.

08

RISHIKIMI I RAPORTEVE FINANCIARE

Ligji për Kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse nuk parasheh obligim për zbatimin për revizionin e obligueshëm në raste të caktuara, si për shembull revizionin e obligueshëm për organizata të mëdha të cilat tejkalojnë një shumë të caktuar të të ardhurave, organizatave të cilat kanë marrë ndihmë prej institucioneve shtetërore etj.

Siç përmendëm më lartë, Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse duhet të analizohet si pjesë e kornizës më të gjerë ligjore, pasi që disa aspekte të caktuara të cilat sillen në punën financiare mund të rregullohen me ligje plotësuese të cilat e rregullojnë një lloj të caktuar të organizatave jofitimprurëse.

Kështu për shembull, sipas Ligjit për shoqata dhe fondacione, është rregulluar obligimi për

rishikimin e raporteve financiare tek shoqatat dhe fondacionet me status me interes publik buxheti vjetor i së cilave është mbi 20.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht organizatave me buxhet mbi 100.000 euro në kundërvlerë denari sipas bursës së mesme të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, obligohen të zbatojnë revizion në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Me kornizën ligjore ekzistuese parashihet parim i përgjithshëm për udhëheqjen e kontabilitetit sipas Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, nga ana tjetër Ligji për shoqata dhe fondacione implikon se organizatat me status të interesit publik të cilat kanë buxhet mbi

100.000 euro duhet të udhëheqin kontabilitet edhe sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit me ç'rast do ta plotësonin kërkesën për rishikim të obligueshëm i cili është në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Duke e pasur parasysh atë se ekzistojnë dallime esenciale në udhëheqjen e kontabilitetit sipas Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse ku zbatohet parimi i dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste dhe udhëheqja e kontabilitetit sipas Standardeve

ndërkombëtare të kontabilitetit ku zbatohet parimi i krijimit të ndryshimeve afariste (Accrual basis) është e nevojshme të përpunohen dispozita më të afërta për punën e kontabilitetit për organizatat të cilat me ligj të veçantë i nënshtrohen revizionit të obligueshëm i cili është në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.


09

ANALIZIMI I MENDIMIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE JOFITVERITARE


Në kuadër të zbatimit të analizës u bë hulumtim i një ekzemplari të përbërë prej përfaqësuesve të sektorit jofitimprurës. Të anketuari i shprehën qëndrimet e tyre përmes përgjigjes së pyetësorit. Të anketuarit prej 70 organizatave të ndryshme i dhanë komentet e tyre për pyetjet në lidhje me zbatimin praktik të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, identifikimin e mangësive potenciale dhe pjesëve të cilat krijojnë konfuzion në zbatim.

Struktura e ekzemplarit është paraqitur në grafikonët e mëposhtëm:


Struktura sipas llojit të organizatës:



Struktura sipas të ardhurave të përgjithshme 2016



Struktura sipas të ardhurave të përgjithshme 2016



Prej të dhënave të fituara për llojin e organizatës, lartësinë e të ardhurave të realizuara dhe vlerën e mjeteve mund të konstatojmë se pjesën më të madhe të ekzemplarit e përbëjnë organizata të cilat kanë nevojë për udhëheqjen e kontabilitetit dhe dorëzimin e llogarisë përfundimtare në pajtim me Ligjin.

Konstatimet e sublimuara prej përgjigjeve të grupit të fokusit janë dhënë më poshtë në tekst:

1 Sipas burimeve të financimit 53 organizata realizojnë të hyra financiare vetëm prej donacioneve, granteve, ndihmës apo formave të tjera të transfertave të njëanshme. Ndërsa 17 prej tyre realizojnë të ardhura plotësuese prej sigurimit të të mirave dhe shërbimeve. Të ardhurat plotësuese zakonisht vijnë prej aktiviteteve të cilat lidhen me marrjen me qira të hapësirës, zbatimin e kurseve, punëtorive,

shërbimeve konsulente, shitjen e produkteve të cilat janë përpunuar prej anëtarëve të organizatës etj.

Këtu mund të konstatojmë se natyra e aktiviteteve sektoriale kryesisht është me karakter jofitimprurës pa pjesëmarrjen e konsiderueshme në treg përmes zbatimit të aktiviteteve afariste plotësuese.

Rezultatet prej pyetësorit anketues përkojnë me të dhënat e Raportit për vlerë ekonomike të sektorit jofitimprurës në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë¹ i përgatitur nga Qendra e Maqedonisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Ky raport jep të dhëna për strukturën e të ardhurave në vitin 2014, me ç'rast në nivel sektorial 68% e të ardhurave të përgjithshme janë realizuar prej donacioneve dhe granteve, 20% u takojnë të ardhurave të tjera, 6% të ardhurave prej shitjes së produkteve dhe 6% prej të ardhurave të shërbimeve 6%.

Kjo e përcakton edhe nevojën për ndarjen e evidencës së kontabilitetit, gjegjësisht të ardhurave prej zbatimit të veprimtarisë të evidentohen në llogari të veçanta prej të ardhurave në bazë të anëtarësisë, donacioneve, ndihmave etj.

Për këtë qëllim, nevojitet përshtatje e planit të kontabilitetit gjegjësisht rregullimit të evidencës sintetike përkatëse sipas llojit të të ardhurave, siç është elaboruar më lartë në analizë.

Kjo çështje është me rëndësi të madhe për kontrollet tatimore, pasi që për shkak të natyrës së financimit dhe rëndësisë margjinale të të ardhurave prej kryerjes së veprimtarisë, organizatat jofitimprurëse hyjnë në regjim tatimor të veçantë gjegjësisht gëzojnë lirime të caktuara tatimore. Në pajtim me Ligjin për

1 <http://mcms.mk/images/docs/2016/izvestaj-za-ekonomskata-vrednost-na-neprofitniot-sektor.pdf>


tatimin e fitimit (Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 112/2014 ..., 190 nga 17.10.2016) obligues i tatimit të fitimit është personi juridik rezident i Republikës së Maqedonisë i cili realizon fitim prej kryerjes së veprimtarisë në vend dhe jashtë vendit.

Te subjektet fitimprurëse, bazë tatimore paraqet fitimi bruto i kontabilitetit që merret si diferencë midis të ardhurave totale dhe shpenzimeve totale. Në sektorin jofitimprurës, shumica e të hyrave janë nxjerrë në bazë të donacioneve, sponsorizimeve dhe ndihmës (transferimeve të njëanshme), në thelbin e tyre ekonomik këto derdhje të mjeteve nuk përbëjnë të ardhura nga kryerja e ndonjë veprimtarie. Kështu, të ardhurat nga donacionet, sponsorizimet, grantet, tarifrat e anëtarësimi, si dhe mjetet e pranuar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit janë dhënë me qëllim për të realizuar programe të caktuara dhe qëllimet e përcaktuara në pajtim me statutin dhe programin, nuk janë lëndë e tatimit me tatimin mbi të ardhurat. Stimujt shtesë tatimore rregullohen edhe me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr 47/06, 86/08, 51/2011, 28/14 dhe 154 / nga 09.04.2015).

Gjithashtu, organizatat që realizojnë të ardhura nga kryerja e veprimtarive duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë se këto të ardhura

përdoren për ta përmbushur qëllimin dhe misionin kryesor. Prandaj, këtu e rëndësishme është edhe pjesa e shpenzimeve, gjegjësisht, evidenca e kontabilitetit të shpenzimeve sipas llojeve, nga ku mund të përcaktohet përshtatshmëria e tyre. Analitika e shpenzimeve është gjithashtu e rëndësishme për kontrollin financiar / tatimor në mënyrë që të përcaktohet nëse organizata i përdor të ardhurat shtesë me qëllim të arritjes të misionit të saj, ose kanë pagesa eventuale të fshehta të fitimit. Duke e pasur parasysh se shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve nuk kanë mundësi të paguajnë fitimet e themeluesve të tyre.

Përveç burimeve kryesore të financimit (donacione, grante, sponsorime) a realizoni të ardhura nga kryerja e aktivitetit ekonomik?



2


Gjithsej 35 organizata kanë dorëzuar shqyrtimin e raporteve financiare deri tek palët e interesuara vijuese:

- Donatorë – si mbështetje për realizimin e projekteve dhe aplikimin për projekte të reja;
- Revizorë – për revizionin e raporteve financiare vjetore.
- Policia financiare dhe Drejtoria për të Hyra Publike – për qëllime të kontrollit.

Nga ana tjetër, po aq organizatave (35) asnjëherë nuk u janë kërkuar raporte financiare për shqyrtim prej asnjë pale të interesuar.

Përqindja e madhe e organizatave të cilat asnjëherë nuk kanë pasur nevojë të dorëzojnë për shqyrtim raporte financiare tregon për atë se informacioni financiar i cili merret me leximin e llogarisë përfundimtare është me rëndësi relative. Në vend të kësaj donatorët, bankat dhe palët e tjera të interesuara preferojnë strukturim më të detajuar të informacionit financiar nga menaxhmenti i organizatës.

Deri më tani a keni dorëzuar në shqyrtim raporte financiare me kërkesë të institucioneve shtetërore (përveç nëse është e aplikueshme, dorëzimi i rregullt i llogarisë përfundimtare), do natorë dhe palë të tjera të interesuara?



Kjo shpie në përfundimin se formularët aktual për dorëzimin e llogarisë vjetore nuk janë të qarta dhe të sakta dhe nuk u lejojnë palëve të interesuara të marrin informata adekuate dhe të mjaftueshme nëse do t'i analizonin ato. Shumica e donatorëve apo palëve të tjera të interesit angazhojnë revizorë apo profesionistë të tjerë që të mund të mbështeten në të dhënat në raportet financiare.

Evidenca e kontabilitetit sipas sintetikës shfaqet në shumë linja të gjera të raportimit (PADH) me çka lexuesi merr informacionin gjenerik pa pasur pasqyrë në strukturën e degëzuar të të ardhurave, burimet e mjeteve dhe obligimet.


Duke i pasur parasysh specifikat e sektorit jofitimprurës rezultatet e së cilave shpesh nuk kanë përmbajtje kuantitative imponohet nevoja për shfaqjen narrative të qëllimeve të realizuara për vitin. Plotësimi i këtyre informacioneve ndaj raportimit financiar e rrit nivelin e cilësisë, relevancës dhe transparencës së raportimit financiar. Përqindja e lartë (50%) e mosshfrytëzimit të raporteve financiare të obligueshme tregon në atë se organizatat shpenzojnë resurse plotësuese për analizën financiare dhe revizionin, që në disa raste të caktuara mund të shmanget nëse ekziston kornizë gjithëpërfshirëse e raportimit financiar.

3

Për sa i përket vlerësimit të përgjithshëm të Ligjit të kontabilitetit për organizatat jo-fitimprurëse, 11 organizata janë përgjigjur se nuk kanë vërejtje ndaj legjislacionit ekzistues, 49 kanë theksuar se dispozitat ligjore ekzistuese janë mjaft të qarta, ndërsa 10 organizata janë përgjigjur se nuk janë të kënaqur me zgjidhjen ligjore.

Organizatave janë mjaft të njohura me kornizën ligjore, por nga këto rezultate del se ekzistojnë çështje që shkaktojnë hezitim dhe pasiguri. Pjesa më e madhe e këtyre çështjeve tashmë janë përfshirë në tekstin e këtij studimi. Gjithashtu studimi duhet të sigurojë një bazë për diskutim të mëtejshëm mes organizatave, grupeve të interesit dhe institucioneve përkatëse për të përmirësuar kornizën ligjore dhe zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore.

Kërkesat minimale për udhëheqjen e kontabilitetit dhe raportimit financiar të cilat rregullohen me Ligjin për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe akteve nënligjore a janë të qarta në masë të mjaftueshme?



4 Në pyetjen nëse dispozitat e Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse mundësojnë raportim financiar transparent, 18 organizata janë përgjigjur se nuk kanë vërejtje me legjislacionin ekzistues, 49 organizata, gjithashtu si në pyetjen e mëparshme, kanë theksuar se legjislacioni ekzistues në masë të mjaftueshme siguron raportimin financiar transparent, ndërsa vetëm 3 nga organizatat që i janë përgjigjur pyetësorit nuk konsiderojnë se ligji ekzistues ofron raportim transparent financiar. Sipas përgjigjeve të theksuara të kësaj pyetje mund të nxirret se njëjtë si në pyetjen e mëparshme nevojat ekzistuese ligjore duhet të pësojnë ndryshime të caktuara në mënyrë të përshtatjes së tyre që të mund të kontribuojnë drejt raportimit financiar më transparent.


Çështja e transparencës është me rëndësi esenciale për tërheqjen e fondeve të reja dhe burimeve të financimit si dhe në efikasitetin e financave dhe kontrolleve tatimore. Përmes rritjes së transparencës ngritet besimi në misionin dhe rezultatet e realizuara ndërsa me atë organizata e rrit kapacitetin e vet për absorbimin e mjeteve të reja financiare.

Edhe pse 70% e të anketuarve janë përgjigjur se me zbatimin e dispozitave të Ligjit në masë të mjaftueshme mundësohet raportim financiar transparent, ngritja e shkallës së transparencës


dhe zbardhja e informacioneve financiare shkon në dobi të përforcimit të kapaciteteve të sektorit jofitimprurës. Veçanërisht duke e pasur parasysh se në këtë sektor ekzistojnë elemente të konkurrencës tregtare pastaj zbardhja e informacioneve financiare në vëllim më të gjerë nuk do të ndikojë në mënyrë të pavoritshme në rezultatet e punës.

5 Në pyetjen nëse dispozitat e Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse mundësojnë raportim financiar gjithëpërfshirës, 17 organizata janë përgjigjur se nuk kanë vërejtje për zgjidhjet ligjore ekzistuese, 42 prej organizatave kanë theksuar se zgjidhjet ligjore ekzistuese në masë të madhe mundësojnë raportim financiar gjithëpërfshirës. Të anketuarit të cilët theksojnë se ligji ekzistues nuk mundëson raportim financiar gjithëpërfshirës, i kanë theksuar ato pjesë të cilat çojnë drejt gjendjes së tillë. Megjithatë kjo përgjigje paraqet indikacion se rregullativa ligjore ekzistuese duhet të rishikohet.

Zbatimi i dispozitave të Ligjit a mundëson raportim financiar transparent?



Zbatimi i dispozitave të Ligjit a mundëson raportim financiar gjithëpërfshirës?




6

61 organizata janë përgjigjur se janë të obliguara për dorëzimin e llogarisë përfundimtare, ndërsa 9 të tjera nuk kanë obligim të tillë. Këto 9 organizata

të cilat janë përgjigjur se nuk obligohen për dorëzimin e llogarisë përfundimtare e plotësojnë kushtin e theksuar në nenin 18, paragrafi 1 dhe kanë të ardhura më të vogla se 2.500 euro. Kjo mund të shihet nga shqyrtimi paraprak ku janë theksuar të dhënat për strukturën e të anketuarve.


Zbatimi i dispozitave të Ligjit a mundëson raportim financiar gjithëpërfshirës?

**7**

Në pyetjen nëse organizata shfrytëzon kontabilitet të jashtëm ose ka shërbim të organizuar për kontabilitet në vetë organizatën, 53 prej organizatave janë përgjigjur se i shfrytëzojnë shërbimet prej kompanisë së jashtme të kontabilitetit e cila ua udhëheq evidencën e kontabilitetit dhe e përpunon llogarinë vjetore, ndërsa 7 nuk kanë dorëzuar të dhëna.

Organizatave jofitimprurëse zakonisht nuk kanë resurse të cilat do të mund t'i angazhonin për udhëheqjen e kontabilitetit në korniza të vetë organizatës dhe vendosin për përdorimin e shërbimeve të jashtme pasi që në të njëjtën kohë marrin shërbime prej profesionistëve të kualifikuar dhe nuk kanë shpenzime shtesë për ndjekjen e ndryshimeve në rregullativën ligjore. Ata që janë përgjigjur se nuk kanë kontabilitet të jashtëm duke u lidhur me përgjigjet e pyetjes paraprake mund të konstatojmë se me siguri bëhet fjalë për organizata të cilat aspak nuk e kanë për obligim udhëheqjen e kontabilitetit të dyfishtë në pajtim me dispozitat e ligjit.

A përdorni kontabilitet të jashtëm?




8

Në pyetjen nëse organizata përdor softuer për kontabilitetin, rezultat i pritshëm se është se të gjitha ato organizata të cilat shfrytëzojnë


kontabilitet të jashtëm nuk duhet të përdorin softuer të kontabilitetit, por rezultatet tregojnë se madje 24 organizata kanë softuer operativ të kontabilitetit të cilin e shfrytëzojnë në punën e tyre. Kjo do të thotë se një pjesë e dokumentacionit evidentohet në kuadër të organizatës, ndërsa më vonë këto të dhëna ndërmerren prej kontabilitetit të jashtëm. Ky softuer gjithashtu tek 15 prej organizatave mundëson gjenerim automatik të raporteve financiare, ndërsa tek 9 prej tyre nuk ekziston kjo mundësi. Më tej 39 organizata kanë dakorduar

se nuk kanë softuer të kontabilitetit i cili është në korrelacion me pyetjen paraprake dhe 7 organizata nuk kanë dorëzuar të dhëna.

Organizata a përdor softuer për kontabilitet?



Softueri a mundëson gjenerim automatik të raportimit financiar?



9

Në pyetjen nëse disa pjesë të caktuara të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe akteve të tjera nënligjore krijojnë


konfuzion në zbatim, 31 prej organizatave janë përgjigjur në mënyrë pohuese gjegjësisht se gjatë punës së tyre janë ballafaquar me pjesë konfuze të Ligjit dhe akteve nënligjore, 32 prej organizatave vlerësojnë se rregullat ekzistuese ligjore janë në rregull dhe se nuk ka konfuzion gjatë zbatimit të tyre, ndërsa 7 prej tyre nuk kanë dorëzuar të dhëna. Zakonisht si problematike organizatat të cilave u krijojnë konfuzion gjatë punës së tyre i theksojnë pjesët vijuese të ligjit:

- Dispozita sipas së cilës shpenzimet njihen në periudhën vijuese nëse nuk paguhen në afat prej 30 ditësh pas skadimit të periudhës përllogaritëse, shfrytëzimi i librave të patjetërsueshëm ndihmës, udhëheqja e kontabilitetit sipas parimit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste gjegjësisht transaksioneve theksohet si dispozitë e cila çon drejt konfuzionit gjatë udhëheqjes së kontabilitetit të organizatës.
- Përgatitja e raporteve të shumta, dokumenteve të shumta dhe procedurat të cilat kërkojnë angazhimin e personelit plotësues për administratë dhe financa në kuadër të orngizatës, joprecizimi i mjaftueshëm nëse oorganizata mund të kryejë aktivitete tregtare përmes të cilave do të realizojë të ardhura plotësuese, kërkesa

për udhëheqjen e librit ndihmës të llogarive dalëse, ndërsa si më të shumta janë vërejtjet lidhur me dispozitat e ligjit për tatimin personal të të ardhurave dhe të ligjit për tatimin e fitimit.

Sipas asaj që është theksuar më lartë do të konstatojmë se është e nevojshme të zbatohen trajnime plotësuese të kontabilistëve me qëllim të zgjidhjes së dilemave rreth parimit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste gjegjësisht transaksioneve me qëllim të zgjidhjes së dilemave dhe paqartësive të cilat paraqiten prej zbatimit të tij. Nga ana tjetër vërejtjet të cilat lidhen me rregullativën tatimore në bazë të rregullt analizohet dhe debatohet me institucionet kompetente.


A ekzistojnë pjesë të caktuara të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe akteve nënligjore të cilat krijojnë konfuzion në zbatim?



10

Në pyetjen nëse në dispozitat ekzistuese ligjore ekzistojnë pjesë të cilat në mënyrë të panevojshme e vështirësojnë udhëheqjen e librave dhe përgatitjen e raporteve financiare, 25 prej organizatave janë përgjigjur në mënyrë afirmative gjegjësisht se gjatë punës së tyre janë përballur me pjesë të Ligjit dhe akteve nënligjore të cilat i konsiderojnë si problematike gjatë udhëhejes së kontabilitetit dhe përpunimit të raporteve financiare, 38 prej organizatave vlerësojnë se dispozitat ekzistuese ligjore janë në rregull dhe se nuk ka dispozita të cilat i konsiderojnë si të panevojshme, ndërsa 7 prej tyre nuk kanë dorëzuar të dhëna. Zakonisht si pjesë të rregullave ligjore ekzistuese për të cilat organizatat vlerësojnë se janë të panevojshme dhe e vështirësojnë udhëheqjen e kontabilitetit dhe përpunimin e raporteve financiare paraqesin: vëllimi dhe pasaktësia në zërat apo paragrafet e formularëve ekzistues për dorëzimin e llogarisë përfundimtare, përgatitja e formularëve plotësues për statistikën, mënyrën e evidentimit dhe përlllogaritjes së revalorizimit të mjeteve afatgjata dhe nevoja e cila paraqitet nga përlllogaritja e revalorizimit të mjeteve afatgjata, dispozita për udhëheqjen e kontabilitetit sipas parimit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste gjegjësisht transaksioneve, mosekzistimi i formularit të veçantë për bilancin tatimor i cili krijon konfuzion gjatë plotësimit të tij.

A ekzistojnë pjesë të caktuara të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe akteve nënligjore të cilat krijojnë konfuzion në zbatim?

**11**

Në pyetjen nëse në dispozitat ekzistuese ligjore ekzistojnë pjesë të cilat nuk janë rregulluar në mënyrë precize, 23 prej organizatave janë përgjigjur në mënyrë afirmative gjegjësisht se gjatë punës së tyre janë ballafaquar me pjesë të Ligjit dhe akteve nënligjore të cilat i konsiderojnë si pamjaftueshëm të rregulluara, 39 prej organizatave vlerësojnë se dispozitat ligjore ekzistuese janë në rregull dhe se nuk ka dispozita të cilat i konsiderojnë si të parregulluara në mënyrë precize apo në mënyrë të pamjaftueshme, ndërsa 8 prej tyre nuk kanë dorëzuar të dhëna. Zakonisht si pjesë të rregullave ligjore ekzistuese për të cilat organizatat vlerësojnë se janë të rregulluara në

mënyrë të pamjaftueshme ose në mënyrë joprecize paraqesin ato në vijim: dispozitat e ligjeve për tatimin personal të fitimit dhe tatimit të fitimit dhe nevoja e sjelljes së zgjidhjeve ligjore të veçanta për organizatat jofitimprurëse, dispozita për udhëheqjen e kontabilitetit sipas parimit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste gjegjësisht transaksioneve, mënyra e evidentimit të tepricës së të ardhurave mbi shpenzimet prej periudhës paraprake, kushtet për marrjen e statusit "Interes publik" gjatë dhurimit të mjeteve prej kompanive.


12

Në pyetjen nëse gjatë dorëzimit të llogarisë përfundimtare në Regjistrin Qendror janë paraqitur vështirësi teknike, 6 prej organizatave janë

përgjigjur në mënyrë pohuese gjegjësisht se janë ballafaquar me vështirësi teknike gjatë dorëzimit të llogarisë përfundimtare edhe atë të gjithë e theksojnë përgjigjen e njëjtë se aplikacioni për dorëzimin e llogarive në Regjistrin Qendror nuk është stabil dhe se në atë periudhë është i stërngarkuar, 47 prej organizatave nuk kanë pasur kurrfarë vështirësish gjatë dorëzimit të llogarisë përfundimtare, ndërsa 17 prej tyre nuk kanë dorëzuar të dhëna.

Këto probleme zakonisht janë të natyrës teknike të sistemit i cili i përfshin llogaritë përfundimtare të dorëzuara dhe stërngarkimin e tij në ditët para afatit përfundimtar për dorëzimin e llogarive përfundimtare të përcaktuar sipas rregullave ligjore në ditët para afatit përfundimtar për dorëzimin e llogarive përfundimtare të përcaktuara sipas rregullave ligjore për të gjitha subjektet të cilat i nënshtrohen këtij obligimi.

A keni pasur vështirësi teknike rreth dorëzimit të llogarisë përfundimtare në Regjistrin Qendror?



10

STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT (IFRS) PËR ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE

Fondacioni IFRS (IFRS Foundation) është organizatë ndërkombëtare e dëshmuar, detyra e së cilës është sjellja dhe zhvillimi i setit të unifikuar të standardeve globale të kontabilitetit. Standardet IFRS (IFRS standards) janë të dizajnuara me qëllim që të sigurojnë transport, besim dhe efikasitet në tregjet financiare nëpër të gjithë botën, si dhe të kontribuojnë në stabilitetin afatgjatë të ekonomisë botërore. Kështu që standardet IFRS janë të domosdoshme në 125 juridiksione ndër të cilat është edhe Maqedonia, ndërsa shumë vende të tjera e lejojnë zbatimin e tyre. Madje, komentet edhe publikimet e Fondacionit përdoren gjerë në zgjidhjen e sfidave në lidhje me kontabilitetin dhe raportimin financiar.

Deri më sot, fokusi i fondacionit kryesisht është drejt dizajnit të standardeve për ekonomi, gjegjësisht nga entitetet fitimprurëse. Edhe pse në disa raste hapet çështja për zgjerimin e kompetencave të një standardi të ri për sektorin jofitimprurës. Në Publikimin² e publikuar në qershor të vitit 2016, udhëheqësit (Trustees) kanë qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Edhe pranohet nevoja për zhvillimin standardeve të posaçme ndërkombëtare për sektorin jofitimprurës. Fondacioni ende nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet në këtë drejtim. Edhe pse udhëheqësit konsiderojnë se kjo është temë

² <https://www.ccab.org.uk/documents/IFRNPO-FullReport-Final-07022014.pdf>

e interesit, por për një kohë më të gjatë. Në Publikimin shpjegohet se arsyeja për këtë janë resurset e limituara, ndërsa sjellja e një standardi të ri për sektorin jofitimprurës nënkupton angazhim masiv i cili kërkon përfshirjen e më shumë organizatave profesionale të rajoneve dhe juridiksioneve të ndryshme, si për shembull organizata të bankierëve, organe rregullatore shtetërore, firma profesionale të kontabilitetit, asociacione të kontabilitetit, etj. Nga ana tjetër, qëllimet e raporteve financiare në sektorin jofitimprurës kanë specifikë të veçantë, e cila dallon nga qëllimet e raportimit financiar në subjektet ekonomike, prandaj sfida është edhe më e madhe.

Përfaqësuesit e fondacionit sqaruan se nevoja për standard ndërkombëtar për sektorin jofitimprurës nuk i arsyeton resurset e rëndësishme që janë të nevojshme për përgatitjen e tij. Para se të gjithash, për shkak se shumica e organizatave jofitimprurëse janë të vogla, nuk kanë operime ndërkombëtare dhe mbështeten për financim në resurset vendore. Gjithashtu shumica e juridiksioneve kanë zhvilluar rregulla dhe ligje të veçanta të kontabilitetit, të cilat e rregullojnë sektorin jofitimprurës, të cilat në masë të madhe janë specifike për një shtet të caktuar, kështu kalimi i standardit të ri ndërkombëtar do të ishte kompleks dhe shumë i shtrenjtë.

Por, mundësia për zgjerimin e kompetencave në të ardhmen ende shqyrtohet dhe bëhen hetime dhe analiza në të cilat janë të përfshirë kryesisht përfaqësuesit e sektorit jofitimprurës, si dhe përfaqësuesit e organizatave profesionale siç janë Asociacioni i Kontabilistëve të Autorizuar (ACCA), CCAB dhe palët e tjera të interesuara. Ku 72% e të anketuarve janë përgjigjur se është e nevojshme të përgatitet standard ndërkombëtar për sektorin jofitimprurës³. Edhe atë, shumica e të anketuarve të cilët e mbështesin këtë qëndrim janë përfaqësues të sektorit jofitimprurës, me argument se Organizatat momentalisht po ballafaqohem në numër të madh të kërkesave nga donatorët për shkak të mungesës së standardizimit në raportimin financiar. Kjo do të thotë se shpenzohen resurse shtesë për sigurimin e informacioneve financiare dhe nëse silltet regjim unik i raportimit të kontabilitetit në nivel ndërkombëtar do të kursehet mjaftueshëm kohë dhe shpenzime administrative. Posaçërisht, kjo është e rëndësishme për Organizatat të cilat kanë lidhje ndërkombëtare, kanë resurse të financimit nga jashtë ose kryejnë aktivitete në më shumë juridiksione.

Pastaj, standardi ndërkombëtar do të jap shembull të qartë për atë se si duhet të duket një raport cilësor financiar dhe do të jetë në dobi për vetë Organizatat, financuesit, ashtu edhe për organet rregullatore shtetërore.

³ <https://www.ccab.org.uk/documents/IFRNPO-FullReport-Final-07022014.pdf>

Ekzistojnë disa çështje kryesore në kontabilitetin për sektorin jofitimprurës, e që s'janë të adresuara në mënyrë adekuate në standardet IFRS, gjegjësisht për çështje për të cilat në përgjithësi ka mungesë së ekspertizës, këto janë:

- transaksione ku njëra palë merr një vlerë të caktuar pa shkëmbyer vlerë ekuivalente (ndihmë, donacione, dhurata),
- shpërndarja e të ardhurave të realizuara nga donacionet, grantet ose mjetet nga burimet e tjera publike dhe private,
- mbikëqyrja dhe dokumentimi i mjeteve të shfrytëzuara që janë dhënë nga palët e treta.

Zbardhja, vlerësimi narrativ i mjeteve të cilat janë specifike për sektorin jofitimprurës (siç janë burimet jo – monetare si dhënia në mallra dhe shërbime) dhe çështjet konceptuale siç janë qëllimet dhe në përgjithësi qëllimi i raporteve financiare në sektorin jofitimprurës.

Çështjet që janë të identifikuar në këtë Publikim janë me rendësi të veçantë për funksionin e kontabilitetit në sektorin jofitimprurës. Në kushte kur nuk kemi standard ndërkombëtar, mbetet që këto çështje të përpunohen në nivel lokal dhe në mënyrë të përshtatshme të inkorporohen në rregulloren vendore.

Ajo që ekziston si Publikim dhe hetim ka të bëjë më shumë me identifikimin e specifikave në sektorin jofitimprurës në aspektin e

transaksioneve, kërkesave të palëve të interesuara dhe implikimeve financiare të karakterit jofitimprurës etj., por nuk ekziston kornizë e unifikuar e raportimit e cila është e pranuar në përgjithësi si praktika më e mirë ndërkombëtare në këtë fushë, për dallim nga ekonomia ku, standardet IFRS siguruan në masë të madhe barazim në raportimin financiar në mes kompanive të nivelit ndërkombëtar.

Rekomandimet që janë dhënë në këtë analizë, sidomos në lidhje me rishqyrtimin dhe plotësimin e Planit të Kontabilitetit, zbardhjes narrative në raportet financiare, prezantimit ndaras të të ardhurave nga donacionet dhe të ardhurave nga kryerja e një aktivitetit shkojnë në drejtim të përshtatjes së raporteve financiare ndaj specifikave të sektorit jofitimprurës.

PËRFUNDIMI

Sektori jofitimprurës për shumë gjëra dallon nga ekonomia. Para se gjithash, sipas aktiviteteve, qëllimeve të punës dhe financimit të operimeve. Këtu imponohet nevoja për raportim financiar dhe rregullat për kontabilitetet të cilat më shumë përshtaten me këto specifika. Në nivel global, mangësi e madhe është mospasja e një standardi të kontabilitetit që do ishte i pranueshëm në përgjithësi për organizatat jofitimprurëse, i cili do të kontribuonte për unifikimin në raportim dhe krijimin e praktikës më të mirë në këtë fushë. Kështu çdo shtet sjell rregulla të veta të cilat në masë të madhe dallojnë prej njërit në tjetrin juridiksion. Përfundimi i përgjithshëm është se

këto dallime në raportimin financiar nëpërmjet rajoneve të ndryshme krijon më shumë shpenzime nga ana e sektorit jofitimprurës, para se gjithash në aspekt të paraqitjes para financuesve, bankave ose palëve të tjera të interesuara.

Sektori jofitimprurës në Maqedoni është me rëndësi të veçantë për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, prandaj krijimi i mjedisit të mundshëm në të cilin do të realizohet një lloj qëndrueshmërie të organizatave qytetare do ta varet para se gjithash nga kapacitetet për të tërhequr fonde e sidomos financime nga jashtë vendit. Nisur nga kjo, me rëndësi

të veçantë është funksionin administrativ në kuptim të prezantimit të pasqyrimin financiar të organizatës si dhe mundësimin e transparencës në raportim.

Roli i Ligjit për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse dhe akteve nënligjore është të vendosë kornizë të raportimit financiar dhe përpunimit të dokumenteve të kontabilitetit që të sigurohet pikë efikase dhe informim financiar me kohë, ndërsa kjo padyshim është në funksion të zhvillimit të sektorit.

Nga analiza e fokus grupeve konkludojmë se organizata në Maqedoni kanë kapacitete të ulëta financiare, gjegjësisht vetëm 5% (4/70 organizata) realizojnë të ardhura vjetore prej mbi 50 milionë denarë. Gjithashtu, shkalla e shfrytëzimit të softuerit të kontabilitetit dhe automatizimit është i mesatar dhe këtu ka ende ka hapësirë për avancim. Gjithashtu befasuese është përqindja e organizatave të cilat kurrë nuk kanë pasur nevojë për raporte financiare (përveç për qëllime për raportim të patjetërsueshëm financiar deri te institucionet kompetente), madje 50% nga ekzemplarët e analizuar (35/70). Kjo çon deri te nevoja për avancimin e cilësisë së raportimit me qëllim që të rritet relevanca e raportimit të patjetërsueshëm financiar.

Megjithatë mund të konkludojmë se Ligji për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse së bashku me aktet nënligjore të cilat më

hollësisht e rregullojnë përmbajtjen e planit të kontabilitetit, format e raporteve financiare, kërkesat administrative dhe principet për mënyrën e udhëheqjes së kontabilitetit, etj, japin kornizë të unifikuar të raportimit financiar në nivel sektorial. Përmes analizës të rregullores ekzistuese ligjore, si dhe nga rezultati i pyetësorit dhe përgjigjeve të përfaqësuesve të fokus grupeve arritëm deri te disa rekomandime të prezantuara nga kapitulli në vijim. Rekomandimet për avancim dhe përmirësim konsiderojmë se duhet të miratohen në të njëjtën kohë në ligjin dhe në rregulloren për udhëheqjen e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse, ndërsa sa i përket akteve nënligjore konsiderojmë se planit të kontabilitetit duhet t'i bëhet ridefinim i tërësishëm, gjegjësisht të sillet rregullore e re për formën dhe përmbajtjen e planit të llogaritjes.

Gjatë analizës u hap edhe çështja e raportimit në aspekt të kryerjes së aktiviteteve ekonomike nga ana e OSHC duke marrë parasysh se e njëjta është legale përderisa përfitimi nga aktivitetet e tilla shfrytëzohet për qëllime të përcaktuara me statusin e OSHC. Nga diskutimet që i bëmë erdhëm në përfundim se është e mundshme që OSHC të cilat kryejnë edhe aktivitete ekonomike të dorëzojnë edhe bilanc të veçantë tatimor, me të cilin veçmas do të raportohet për aktivitetet e këtilla. Ndonjëherë aktivitetet e këtilla ndërthuren me aktivitetet e tjera të OSHC dhe me qëllim që të shmangen paqartësitë, dorëzimi

i një bilanci të veçantë tatimor në masë të madhe do t'i sqaronte këto paqartësi. Nga ana tjetër, organet shtetërore do të merrnin informacione të sakta se sa nga OSHC me të vërtetë kryejnë aktivitete ekonomike. Në raste të caktuara, subjekte të regjistruara në pajtueshmëri me LSHF realizojnë të ardhura të cilat prekin thellë në pjesën e aktiviteteve ekonomike me ç'rast parashtrohet pyetja për trajtimin e tyre në aspektin tatimor. Pa hyrë në pjesën e rregulloreve tatimore, ia vlen të shqyrtohet edhe çështja në aspekt të asaj se ato OSHC që kryejnë aktivitete nga karakteri ekonomik a dorëzojnë bilanc të veçantë tatimor, me çfarë do të lehtësohej edhe puna e OSHC dhe e kontabilistëve të tyre, por edhe ligjdhënësi do të kishte pasqyrim më të mirë për aktivitetet e këtilla nga ana e OSHC dhe ta rregullonte çështjen për (mos) tatimimin e tyre.

REKOMANDIME

Korniza ligjore e cila e rregullon materien e kontabilitetit dhe punës të kontabilitetit të subjekteve jofitimprurëse në Republikën e Maqedonisë veç më është e themeluar. Nisur nga kjo, nga analiza e dispozitave ligjore, mund të formojmë konkludimet dhe rekomandimet e rëndësishme për përmirësimin e mëtutjeshëm dhe revizionin e dispozitave të caktuara, me qëllim që të bëhet përshtatja e kornizës ligjore me gjendjet dhe nevojat reale në sektorin jofitimprurës, siç vijon :

1

Udhëzime për përmirësimin e kërkesave administrative dhe mënyrës së udhëheqjes së kontabilitetit

Identifikohet nevoja për unifikimin e Ligjit me Rregulloren e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse në pjesën e rregullave për ndalimin/fshirjen e transaksioneve të gabuara nga evidenca e kontabilitetit dhe udhëheqjes së librave ndihmëse.

2

Sjellja e një akti të ri nënligjor për përmbajtjen dhe formën e Planit të kontabilitetit

Me Planin e kontabilitetit rregullohen llogaritë e patjetërsueshme sintetike (me tri pozita) në të cilat organizatat i evidentojnë gjendjen dhe lëvizjet e mjeteve, burimet e mjeteve, të ardhurat dhe të hyrat e tjera, shpenzimet dhe daljet e tjera, përcaktimin dhe sistemimin e rezultatit prej punës. Plani i kontabilitetit përbëhet prej klasave, më tej në kornizat e çdo klase janë përpunuar llogari përkatëse në të cilat grupohen lloje të ngjashme të mjeteve, burime të mjeteve dhe të ardhurat dhe shpenzimet. Plotësimet dhe ndryshimet në planin e kontabilitetit duhet të lëvizin në dy drejtime:

- Llogaritë e patjetërsueshme sa më afër të përkohet me transaksionet dhe ngjarjet e kontabilitetit të cilat janë tipike për organizatat jofitimprurëse.
- Përshkrim i saktë i llogarive, që të shmanget pasiguria në përzgjedhjen e llogarisë më përkatëse për një lloj të caktuar të transaksionit ose ngjarjes së kontabilitetit.

Më konkretisht, këtu identifikohet terminologjia jopërkatëse në përshkrimin e faturave të caktuara të klasës 4 (shpenzime). Disa fatura të caktuara në këtë klasë përmbajnë përshkrim të tipit të: (42) Mjete për qëllime të veçanta (43) Mjete të bartura (430) Mjete të bartura në subjekte të tjera (44) Mjete kapitale dhe të tjera (440) Mjete për objekte ndërtimore (441) Mjete për pajisje (442) Mjete të tjera kapitale. Termi "mjete" është tërësisht jopërkatës për këtë klasë duke e pasur parasysh se klasa 4 përmban vetëm fatura të shpenzimeve dhe këtu nuk mund të bëhet fjalë për çfarëdo "mjetesh". Kështu përdorimi i termit "mjete" është tërësisht jopërkatës dhe duhet të zëvendësohet me "shpenzime".

Edhe një rekomandim lidhur me Planin e kontabilitetit ka të bëjë me faturat për shpenzimet dhe të ardhurat të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt lidhen me misionin dhe qëllimet e organizatave, ku do të duhej përveç asaj të referohen në mënyrë terminologjike si shpenzime në funksion të veprimtarisë, të ketë ndarje më të

detajuar dhe ndarje sipas llojeve të shpenzimeve gjegjësisht llojeve të të ardhurave, në vend të grupimit të deritanishëm të gjerë të shpenzimeve gjegjësisht të ardhurave me natyrë të ndryshme të një llogarie sintetike. Me atë do të bëhet distnikcion i qartë midis shpenzimeve të cilat janë në funksion të qëllimeve të SHOC me ato të cilat heqin dorë prej qëllimeve të tilla, ndërsa paraqesin edhe shpenzim të panjohur tatimor (në pajtim me rregullativën tatimore).

Më tej, duke u nisur sipas parimit të kontabilitetit të dukurisë së modifikuar të ndryshimeve afariste gjegjësisht transaksioneve, prej njëres anë organizatat e SHC e evidentojnë si shpenzim shumë të plotë të mjeteve kryesore në periudhën e krijimit të shpenzimit apo në afat prej 30 ditësh pas skadimit të periudhës përlllogaritëse me kusht obligimi për pagesën është krijuar në atë periudhë përlllogaritëse. Nga ana tjetër, amortizimi për mjetet kryesore evidentohet si zvogëlim i njëkohshëm i fondit afarist (burimet e financimit) dhe zvogëlimin e mjeteve. Që këtu, llogaria për amortizim (406) në kuadër të klasës 4 të shpenzimeve krijon konfuzion për mënyrën e evidentimit të amortizimit. Kjo llogari si e pazbatueshme duhet të fshihet prej Planit të kontabilitetit dhe prej Rregullores për përmbajtjen e disa faturave të caktuara në Planin e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse.

3**Heqja e obligimit për revalorizimin vjetor të mjeteve afatgjata**

Revalorizimi vjetor ka rëndësi të vogël ose aspak nuk ka në situatë kur rritja e çmimeve tek prodhuesit e produkteve industriale është madhësi negative edhe në kushte kur lëvizjet inflatore në ekonomi janë shumë të ulëta dhe stabile. Në rrethana të tilla revalorizimi vjetor paraqet vetëm barë administrative pa kurrfarë efekti ose efekt të parëndësishëm të raporteve financiare. Duke e pasur parasysh atë se indikatorët makroekonomikë janë stabile me vite të tëra propozojmë të hiqet obligimi për revalorizimin vjetor të mjeteve ekzistuese.

4**Pjesa narrative dhe shënime si plotësim i raporteve financiare**

Raportet financiare të cilat dorëzohen në Regjistrin qendror duhet të plotësohen me pjesën narrative dhe shënimet shpjeguese me çka do të përmirësohet leximi i raporteve financiare dhe të rritet transparenca në raportim.

5**Njohja e mjeteve ekzistuese sipas pritjeve të menaxhmentit për përdorimin e ardhshëm të një mjetit të caktuar dhe dobive të parapara të****ardhshme.**

Sipas zgjidhjes aktuale, mjetet afatgjata vlera e mëvetësishme e së cilave për momentin e furnizimit është më e lartë se 300 euro në kundërvlerë denari klasifikohet si mjete kryesore. Me ç'rast nuk merren parasysh karakteristikat e mjetit dhe nevojave specifike të organizatës. Në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit një mjet duhet të shfaqet si mjet afatgjatë vetëm nëse është e sigurt se dobitë e ardhshme ekonomike do të paraqesin të ardhura për entitetin dhe nëse vlera e furnizimit të mjetit mund të matet në mënyrë të besueshme, pavarësisht shumës e cila është paguar me këtë mjet. Vlerësojmë se pritjet e menaxhmentit për përdorimin e ardhshëm të një mjeti të caktuar dhe dobitë e parapara të ardhshme janë kritere valide për njohjen se vlerën e mjetit në shumë absolute.

6

Definimi preciz i kriterit për përcaktimin e organizatave jofitimprurëse “mikro”, të cilat nuk obligohen të dorëzojnë llogari

përfundimtare.

Organizatave jofitimprurëse vlera e përgjithshme e së cilave e pronës apo të ardhurave vjetore është më e vogël se 2.500 euro në kundërvlerë denari nuk obligohen të përpilojnë raporte financiare. Këto organizata obligohen të udhëheqin së paku libër për arkën dhe libër të të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësojmë se, vlera e pronës gjatë përcaktimit të madhësisë së organizatës nuk është kriteri më përkatës, veçanërisht nëse e vëzhgojmë në mënyrë të veçantë, duke mos i marrë parasysh edhe mjetet vijuese.

Të ardhurat e përgjithshme nga ana tjetër janë tregues i drejtpërdrejt i vëllimit të aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në lëvizjet financiare të sektorit jofitimprurës. Zbatimi i vetëm këtij kriteri mundëson klasifikim më real dhe më konsekuent si dhe tejkallim të dallimeve në interpretimin dhe zbatimin e Ligjit.

7

Vendosja e kriterëve për përcaktimin e organizatave të mëdha jofitimprurëse, si dhe obligimi për rishikimin e raporteve financiare për

organizatat e mëdha

Duke e pasur parasysh se organizatat në bazë të programeve të tyre për punë dhe aktivitete të planifikuara kanë mundësi për tërheqjen masovike të mjeteve financiare prej opinionit më të gjerë, imponohet nevoja për revizionin e patjetërsueshëm të organizatave të mëdha jofitimprurëse, gjegjësisht obligimit të rregulluar për revizionin e obligueshëm të raporteve financiare në rast se organizata tejkalon një limit të caktuar të të ardhurave vjetore.

Ekziston edhe një aspekt i cili është me rëndësi të madhe për sektorin jofitimprurës, ndërsa nuk paraqet çështje të drejtpërdrejt të kontabilitetit. Organizata mund të realizojë të ardhura prej veprimtarisë nën kushte të caktuara, por konsiderohet se këto organizata themelohen kryesisht me qëllim jofitimprurës. Prandaj, organizatat jofitimprurëse hyjnë në regjimin tatimor të autorizuar, gjegjësisht shfrytëzojnë beneficione të caktuara tatimore. Por këtu duhet të merren parasysh situatat ku organizata bën aktivitete të orientuara komerciale në vëllim të konsiderueshëm dhe paraqet konkurrencë jolojale për kompanitë private të cilat merren me aktivitete të njëjta apo të ngjashme. Nga ana tjetër nëse organizata nuk ka aktivitete të

rëndësishme të interesit më të gjerë shoqëror por zbaton aktivitete të cilat për nga natyra e tyre janë të orientuara nga një grup i caktuar i palëve të interesuara. (p.sh. shërbime për ndihmë në rrugë, trajnime dhe seminare), duhet të analizohet trajtimi i të ardhurave të cilat vijnë prej këtyre palëve të interesuara. Gjegjësisht nëse mjetet e paguara përdoren vetëm në funksion të zbatimit të disa shërbimeve të caktuara për pagesin në vend se për realizimin qëllimti me dobi shoqërore, tek pagesat e tilla ka më shumë elemente nga të ardhurat nga zbatimi i veprimtarive sesa elemente të donacionit, anëtarësisë apo ndihmës për organizatën jofitimprurëse.

Gjithashtu nuk duhet të lihet anash nga analiza pjesëmarrja e të ardhurave prej aktiviteteve komerciale të cilat janë komplementare me

aktivitetet për realizimin e qëllimit përgjegjës shoqëror. Si për shembull organizimi i ngjarjeve humanitare për të cilat bëhet promovimi dhe shitja e produkteve, të drejtuara nga një grup i targetuar i konsumatorëve potencial gjegjësisht pjesëmarrës të ngjarjes.

Që të shmangen keqpërdorime eventuale, në kornizën juridike duhet të jepet autorizim në institucionin kompetent për kontrollin dhe përcaktimin e gjendjes faktike lidhur me veprimtarinë e organizatës. Kështu nëse përcaktohet se sipas esencës së vet ekonomike aktivitetet e organizatës kanë qëllim komercial dominues, institucioni i autorizuar të ketë të drejtë të imponojë dorëzimin e raportimit financiar dhe tatimor në regjim për entitetet përfituese.

